

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXI, nr. 6363  
E mërkurë, 14 korrik 2021  
çmimi 0.40 €

## Kurti dhe Vuçiqi takohen më 19 korrik në Bruksel



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

ENDE NUK DIHET SHKAKTARI I HELMIMIT TË MIJËRA QYTETARËVE TË DEÇANIT

## DEÇANI SHPALL GJENDJE EMERGJENTE PAS HELMIMIT TË MIJËRA QYTETARËVE



Helmimi i mijëra qytetarëve në Deçan ka bërë që kjo komunë të martën të shpallë gjendje emergjente. Dyshimet e para kanë qenë për helmime nga uji i pijes, por ende nuk dihet shkaktari

kryesor. Rezultatet e para laboratorike nuk flasin për helmim hidrik. Presidentja Vjosa Osmani pret që institucionet shumë shpejt ta zbardhin shkaktarin e helmimit, kurse

kryeministri Albin Kurti ka thënë se qeveria do t'u përgjigjet nevojave të qytetarëve të Deçanit. Sipas autoriteteve lokale, numri i qytetarëve që kanë kërkuar ndihmën e mjekut është rreth

## KURTI PËR MARRËVESHJEN E UASHINGTONIT: KA DISA PIKA QË JANË PROBLEMATIKE PËR KUSHTETUTËN TONË



Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, ka mohuar të ketë thënë se nuk do ta marrë parasysh të gjithë marrëveshjen e Uashingtonit. "Ne nuk duam që ta neglizhojmë në parim, por

në të njëjtën kohë duhet të jemi të kujdesshëm, sepse janë disa pika problematike për Kushtetutën tonë e që janë nënshkruar si zotime nga kryeministri paraprak", ka thënë Kurti

**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.PK.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

### SPORT

JANUZI DHE CARIOCA TE  
DUKAGJINI, MUNGON VETËM  
ZYRTARIZIMI



**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Franca ngutet për t'u vaksinuar

PARIS, 13 KORRIK - Rreth një milion persona kanë bërë terminë për vaksinim kundër koronavirusit brenda një dite në Francë, pasi presidenti Emmanuel Macron ka rritur presionin ndaj secilit për t'u vaksinuar dhe për t'i uajtur pushimet verore si dhe ekonominë e shtetit. Një aplikacion që analizon

terminët për vaksinim, bashkë me terminë të tjerë, Doctolib, ka njoftuar të martën në mëngjes se një ditë më parë 926 000 persona kanë bërë terminë për vaksinim, njëherësh rekord ditor, prej nisjes së procesit të imunizimit në dhjetor të vitit të kaluar. Personat nën moshën 35-vjeçare kanë bërë 65 për qind

të terminëve. Macroni ka thënë se vaksinimi do të jetë obligues për të gjithë punëtorët shëndetësorë nga 15 shtatori. Teksa numri i të infektuarve rritet sërish në Francë, ka pasur pritje që Macroni do të bëjë ndonjë kërkesë për vaksinim, me qëllim të rritjes së numrit të terminëve.

Rreth 41 për qind e popullsisë franceze është vaksinuar plotësisht, ndonëse procesi i imunizimit është ngadalësuar teksa kanë nisur pushimet verore. Ministri i Shëndetësisë, Olivier Veran, ka mirëpritur interesimin e rikthyer në vaksina, duke i thënë televizionit BFM se "mijëra jetë



po shpëtohen". Më shumë se 111 000 persona me koronavirus tashmë kanë vdekur në Francë.

# ShBA-ja ndihmon Haitin për hetimin e vrasjes së presidentit

WASHINGTON, 13 KORRIK - Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) janë duke ndihmuar Haitin në hetimet për vrasjen e presidentit Jovenel Moïse, ka thënë Departamenti Amerikan i Shtetit (DASH). Shtëpia e Bardhë ka lënë të hapur mundësinë e dërgimit të trupave ushtarake, me kërkesë të Haitit.

Departamenti Amerikan i Drejtësisë ka thënë se ai, bashkë me agjenci të tjera qeveritare në ShBA, janë duke i ndihmuar policisë në Haiti "me kërkesë të qeverisë haitiane". "Zyrtarët amerikanë kanë kryer një vlerësim fillestar në Haiti. Departamenti do të vazhdojë ta mbështesë qeverinë haitiane për rishikimin e fakteve dhe shkaqeve që lidhen me këtë sulm rrëqethës", ka thënë

Departamenti i Drejtësisë përmes një deklarate.

Në të është thënë edhe se DASH-i do të hetojë nëse është shkelur ndonjë ligj amerikan. Zëdhënësjja e Shtëpisë së Bardhë, Jen Psaki, ka thënë se ShBA-ja është ende duke analizuar kërkesën e bërë nga kryeministri në detyrë i Haitit për dërgim të trupave amerikane atje, me qëllim të ofrimit të ndihmës për sigurim të aeroportit dhe infrastrukturës tjetër, pas vrasjes së presidentit Moïse javën e kaluar.

Ajo ka thënë se, ndonëse administrata Biden nuk ka hedhur poshtë mundësinë e dërgimit të trupave, udhëheqësia politike në Haiti mbetet e paqartë.

Zyrtarët amerikanë kanë



udhëtuar në Haiti më 11 korrik për ta analizuar situatën si dhe janë takuar me tre politikanë të cilët kanë dhënë arsye të ndryshme pse duhet marrë pushtetin. "Çfarë ka qenë e qartë në këtë udhëtim është se ka mungesë të qartësisë për të

ardhmen e udhëheqësisë politike", ka thënë Psaki. Presidenti amerikan Joe Biden u ka thënë gazetarëve se administrata e tij "është duke shikuar nga afër" zhvillimet në Haiti. "Njerëzit e Haitit meritojnë paqe e siguri dhe liderët politikë

në Haiti duhet të bëhen bashkë për të mirën e shtetit", ka thënë Bideni.

Moïse, 53-vjeçar, është qëlluar në orët e para të mëngjesit të 7 korrikut në rezidencën e tij, derisa gruaja e tij Martine është plagosur rëndë.

Kryeministri në detyrë, Claude Joseph, ka thënë se tani është në krye të shtetit, i cili nuk ka parlament aktiv dhe ka dështuar t'i mbajë zgjedhjet legislative në tetor të vitit 2019.

E drejta e Joseph për ta udhëhequr shtetin është sfiduar nga dy politikanë të tjerë, kryeministri i nominuar më parë, Ariel Henry dhe presidenti i Senatit, Joseph Lambert. Autoritetet në Haiti kanë thënë se një grup vrasësish, duke përfshirë 26 kolumbianë dhe dy haitianë-amerikanë, kanë kryer vrasjen.

## Krivokapiqi: Zgjedhjet s'mund të ndodhin shpejt, Mali i Zi jeton në të kaluarën

PODGORICË, 13 KORRIK - Zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare në këtë çast nuk do t'i përshtaten asnjë strukture politike, ka thënë kryeministri i Malit të Zi, Zdravko Krivokapiq. Në një intervistë për "RTCG", ai ka thënë se do të dëshironte që një rishikim i besimit të qeveria të niste në Kuvendin malazez. "Zgjedhjet janë masa dhe zgjidhja më e mirë për marrëdhëniet në skenën

politike të Malit të Zi. Sa di unë, ato nuk korrespondojnë me asnjë strukturë politike. Nuk ka asnjë legjislacion zgjedhor dhe ata e dinë që në këtë moment të gjithë po humbasim energjinë dhe asgjë e re nuk do të ndodhë në skenën politike. Ata e dinë se nuk ka qeveri të ardhshme pa koalicionë dhe ata e dinë që pjesëmarrja do të ishte më e ulët se më 30 gusht. Ata e dinë që

njerëzit kanë dhënë besim se kjo do të zgjasë për katër vjet, në mënyrë që të mund të dalim pa premisë me një votim të sigurt. Kjo është arsyeja pse unë besoj se zgjedhjet nuk mund të ndodhin kaq shpejt", ka thënë kryeministri malazez. Ai ka theksuar se gjatë votimit të mocionit të mosbesimit në qeveri duhet të fillojë procedura e propozimit të një kryeministri të ri të caktuar.

Krivokapiqi ka thënë se ndarjet në Mal të Zi janë rezultat i asaj që është imponuar artificialisht. "Nëse një ngjarje ka ndodhur, ajo nuk duhet të rezultojë në ndarje, sepse ne jetojmë së bashku. Rezultoni se ne jemi të ndarë me veten tonë, pastaj ne grindemi pa asnjë kuptim. Ne jemi vazhdimisht duke u kthyer në të kaluarën. Mali i Zi jeton në të kaluarën", ka thënë Krivokapiqi.



## Të paktën 60 të vdekur si pasojë e zjarrit në një spital në Irak



BAGDAD, 13 KORRIK - Më shumë se 60 persona kanë vdekur në Irak pas shpërthimit të zjarrit në një departament spitali për pacientë me koronavirus. Shpërthimi në spitalin Al-Husein, në qytetin jugor Nasiriya, është vënë nën kontroll në orët e vona të së hënës. Shkaku i zjarrit nuk dihet ende, mirëpo raportimet

fillestare sugjerojnë se ka nisur pas shpërthimit të një cilindri me oksigjen. Kryeministri irakian Mustafa al-Kadhemi ka urdhëruar arrestimin e drejtorit të spitalit. Familjarët e pacientëve kanë protestuar jashtë ndërtesës. Agjencia e lajmeve "Reuters" ka raportuar për përleshje me policinë dhe se dy makina

policore janë përfshirë nga flakët. Departamenti i ri ka pasur hapësirë për 70 shtetë dhe është ndërtuar vetëm tre muaj më parë, kanë thënë zyrtarë shëndetësorë për agjencinë e lajmeve "Associated Press". Në muajin prill shpërthimi i një cilindri me oksigjen ka rezultuar po me zjarr, duke

lënë të vdekur 82 persona në Bagdad. Ministri i Shëndetësisë, Hassan al-Tamimi, ka dhënë dorëheqje pas atij zjarri. Sipas të dhënave të Universitetit "Johns Hopkins", autoritetet në Irak kanë regjistruar 1.4 milion persona të infektuar me koronavirus. Prej këtyre, mbi 17 000 pacientë kanë vdekur.

# Kurti për marrëveshjen e Uashingtonit: KA DISA PIKA QË JANË PROBLEMATIKE PËR KUSHTETUTËN TONË

Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, ka mohuar të ketë thënë se nuk do ta marrë parasysh të gjithë marrëveshjen e Uashingtonit. “Ne nuk duam që ta neglizhojmë në parim, por në të njëjtën kohë duhet të jemi të kujdesshëm, sepse janë disa pika problematike për Kushtetutën tonë e që janë nënshkruar si zotime nga kryeministri paraprak”, ka thënë Kurti

PRISHTINË, 13 KORRIK - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, në një intervistë për “European Western Balkans (EWB)”, ka folur për marrëveshjen e Uashingtonit të nënshkruar në Shtëpinë e Bardhë nën ndërmjetësimin e ish-presidentit Donald Trump e të nënshkruar nga ish-kryeministri Avdhullah Hoti dhe presidenti serb Aleksandër Vuçiq. Kurti ka thënë se duhet qenë të kujdesshëm me marrëveshjen e Uashingtonit meqë, sipas tij, disa pika të kësaj marrëveshjeje janë problematike. Në këtë kontekst, Kurti ka përmendur moratoriumin njëvjeçar për të mos lobuar për anëtarësim në institucionet ndërkombëtare.

Gjithashtu, Kurti në këtë intervistë ka mohuar të ketë thënë që thjesht s’do ta marrë parasysh të gjithë marrëveshjen e Uashingtonit, derisa ka shtuar se njohja nga

Izraeli është pika më e vlefshme e marrëveshjes.

Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, partisë fituese të zgjedhjeve të fundit, e ka rikujtuar edhe faktin që Serbia nuk është duke iu përmbajtur zotimeve, duke e përmendur refuzimin për zhvendosje të ambasadës nga Tel-Avivi në Jerusalem. “Unë jam një nga liderët që e kanë mbështetur presidentin Biden, të kundërtën e presidentit Vuçiq, i cili ka lobuar fort për presidentin Trump. Unë s’kam thënë që atë që është nënshkruar në Uashington do ta hedh thjesht tutje, aspak ashtu. Pika e fundit, që ishte njohja e Izraelit për Kosovën, është implementuar dhe është pjesa më e vlefshme e marrëveshjes. Ju duhet ta dini që dy tekstet nuk janë të njëjta. Për shembull, në tekstin e palës serbe ishte shkruar që ambasada do të zhvendoset nga Tel-Avivi në Jerusalem, por



s’ndodhi siç ishte supozuar. Kështu që dy tekste të ndryshme, dy zotime të njëanshme. Ne nuk duam që ta neglizhojmë në parim, por në të njëjtën kohë duhet të jemi të kujdesshëm, sepse janë disa pika problematike për Kushtetutën tonë e që janë nënshkruar si zotime nga kryeministri paraprak. Vetëm sa për ta përmendur, fakti që ne nuk jemi duke lobuar për anëtarësim në organizata ndërkombëtare. Kjo është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës”, ka thënë Kurti për

“EWB”-në.

Kujtojmë se kryeministri Kurti, pasi ishte rrëzuar nga pushteti herën e parë, kishte deklaruar se sapo të vinte në pushtet nuk do ta ratifikonte në Kuvend një marrëveshje të tillë. “Ne nuk kemi detyrime për zotimet e kryeministrit të paligjshëm të Kosovës kur të kthehemi në detyrë. Nënshkrimi i tij poshtë teksteve jokoherente dhe jotransparente është kundër vullnetit të popullit, rendit demokratik dhe shkel Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës.

Ato nuk do të ratifikohen në Kuvendin tonë. Ndërmjetësit duhet të përmbahen nga nxitja e marrëveshjeve që shkaktojnë përçarje të mëtejshme midis Kosovës dhe Serbisë. Vetëm dialogu parimor dhe i përgatitur mirë çon në marrëveshje të drejta dhe të qëndrueshme”, kishte shkruar Albin Kurti në llogarinë e vet në “Twitter”.

Për këtë në shtatorin e vitit 2020 i kishte reaguar Richard Grenell, atëkohë emisar i Trumpit për dialogun, duke e quajtur Kurtin kundërshtar të Amerikës.



## Kurti e takon kryediplomatin grek: Njohja e Kosovës nga Greqia do t’i kontribuonte paqes në rajon

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka takuar të martën ministrin e Jashtëm të Greqisë, Nikos Dendias, të cilit i ka kërkuar ta njohë Kosovën shtet i pavarur. “Greqia dhe Kosova duhet t’i forcojnë marrëdhëniet bilaterale për shkak të lidhjeve të gjata historike dhe qëllimit të përbashkët për një të ardhme

më të mirë në Ballkan”, ka thënë Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, në takimin me ministrin e Jashtëm të Greqisë, Nikos Dendias, në Athinë. Duke e vlerësuar rolin e politikës së jashtme greke ndaj Kosovës, kryeministri Kurti ka thënë se njohja e pavarësisë së Kosovës do t’i kontribuonte paqes dhe sigurisë

në rajon. Kryeministri theksoi edhe rëndësinë që ka përkrahja e shtetit grek për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës”, ka njoftuar zyra e kryeministrit. Sipas kësaj zyre, kryediplomati grek ka thënë se Greqia është e interesuar t’i forcojë marrëdhëniet me Kosovën dhe ta ndihmojë Kosovën për liberalizimin e vizave.

## Kurti dhe Vuçiqi takohen më 19 korrik në Bruksel

PRISHTINË, 13 KORRIK - Takimi i ri në mes të kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti dhe presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, do të mbahet të hënën, më 19 korrik, në Bruksel, ka thënë zëdhënësi i Bashkimit Evropian, Peter Stano. Ai ka konfirmuar se ata do t’i vazhdojnë bisedimet në kontekstin e dialogut për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë. “Ky takim i nivelit të lartë të dialogut do të fokusohet në diskutimin për progresin e

arritur - për hapat e ardhshëm në dialog, i cili është shumë i rëndësishëm për perspektivën evropiane të Kosovës dhe Serbisë”, ka thënë Stano.

Ky është takimi i dytë në mes të Kurtit dhe Vuçiqit në Bruksel.

Për herë të parë dy zyrtarët janë takuar më 15 qershor dhe gjatë takimit kanë paraqitur pozicionet e tyre të kundërta.

Në fund palët kanë thënë se nuk janë pajtuar për asgjë, mirëpo kanë shprehur gatishmëri për vazhdim të dialogut.

Javën e kaluar në Bruksel janë

takuar zëvendëskryeministri i Kosovës për dialog, Besnik Bislimi, me drejtorin e Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Petar Petkoviç. As në këtë takim nuk është arritur ndonjë përparim.

Pala serbe insiston që Kosova ta zbatojë marrëveshjen e Brukselit për formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, derisa pala e Kosovës vlerëson se përgjatë dialogut janë nënshkruar një mori marrëveshjesh që nuk respektohen plotësisht nga



Serbia, duke përfshirë lirinë e lëvizjes, njohjen e diplomave, kontrollet kufitare dhe çështje të

tjera. Dialogu ndërmjet dy vendeve ka nisur më 2011 në Bruksel.



ENDE NUK DIHET SHKAKTARI I HELMIMIT TË MIJËRA QYTETARËVE TË DEÇANIT

# Deçani shpall gjendje emergjente pas helmimit të mijëra qytetarëve

Helmimi i mijëra qytetarëve në Deçan ka bërë që kjo komunë të martën të shpallë gjendje emergjente. Dyshimet e para kanë qenë për helmime nga uji i pijes, por ende nuk dihet shkaktari kryesor. Rezultatet e para laboratorike nuk flasin për helmim hidrik. Presidentja Vjosa Osmani pret që institucionet shumë shpejt ta zbardhin shkaktarin e helmimit, kurse kryeministri Albin Kurti ka thënë se qeveria do t'u përgjigjet nevojave të qytetarëve të Deçanit. Sipas autoriteteve lokale, numri i qytetarëve që kanë kërkuar ndihmën e mjekut është rreth 1 500

**EPOKA E RE**

**Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 13 KORRIK** - Komuna e Deçanit ka shpallur të martën gjendje emergjente për shkak të situatës së krijuar në këtë komunë pasi qindra qytetarë kanë kërkuar ndihmën e mjekut me simptoma të helmimit. Institucionet kanë bërë me dije se po bëjnë maksimumin për t'u dalë në ndihmë qytetarëve dhe për ta gjetur shkaktarin e helmimit.

Dyshimet e para kanë qenë se qytetarët janë helmuar nga uji i pijes, por analizat e mostrave të ujit nga ujësjellësi "Hidrodrini", të cilat i ka bërë IKShPK-ja, flasin se uji në zonat ku është dyshuar është brenda normave.

Pas shpalljes së gjendjes emergjente, këtë komunë e kanë vizituar presidentja e vendit, Vjosa Osmani dhe disa ministra. Kryeministri Albin Kurti, i cili gjendet në një vizitë zyrtare në Greqi, ka thënë se qeveria do t'u përgjigjet nevojave të qytetarëve të

Deçanit. "Të dashur qytetarë të komunës së Deçanit, në pamundësi për të qenë pranë jush, meqë jam në vizitë zyrtare jashtë vendit, kam komunikim të vazhdueshëm me institucionet përgjegjëse. Në bisedë me kryetarin e komunës, Bashkim Ramosaj, jam njoftuar për gjendjen emergjente në Komunën e Deçanit. Për të konkretizuar mbështetjen e qeverisë dhe për t'u njoftuar nga afër me situatën, sot në Deçan janë zëvendëskryeministrja znj. Donika Gërvalla dhe ministri i Shëndetësisë,

z. Arben Vitia. Qeveria e Republikës së Kosovës do t'u përgjigjet nevojave të qytetarëve të prekur nga infeksioni deri në përmirësimin e gjendjes. Bashkëndiej shqetësimin tuaj dhe ju dëshiroj shërim sa më të shpejtë!", ka shkruar Kurti në llogarinë e vet në "Facebook".

Kurse ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, pas vizitës në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Deçan, ka thënë se bashkë me kryetarin e komunës dhe drejtorin e Drejtorisë për Shëndetësi kanë hartuar një listë barnash që do të trajtohet me prioritet. Ai ka bërë me

## Osmani pret që institucionet ta zbardhin shkaktarin e helmimit

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka deklaruar që institucionet shumë shpejt ta gjejnë shkaktarin e helmimit të qytetarëve të Deçanit. Pas vizitës në këtë komunë, Osmani ka thënë se ka pasur qytetarë të helmuar të cilët nuk kanë qenë të furnizuar nga burimi i njëjtë i ujit. "Ka edhe qytetarë që vijnë nga fshatrat e tjerë e që s'janë furnizuar nga ai burim i ujit. Përveç analizave kimike, ne po i presim edhe ato biologjike të cilat presim të përfundojnë brenda disa orëve. Pres që institucionet e drejtësisë dhe ato të hetuesisë ta trajnojnë rastin me urgjencë dhe sa më parë që të jetë e mundur ta dimë shkakun e helmimit", ka thënë ajo. Osmani ka thënë se institucionet do të bashkëpunojnë çdo ditë me institucionet lokale që kjo gjendje të tejkalohet.

## Konjufca i ofron bashkëpunim komisionares për informim dhe privatësi

Prishtinë, 13 korrik - Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Glauk Konjufca, ka pritur të martën në takim komisionaren e Agjencisë për Informim dhe Privatësi, Krenare Sogojeva - Dërmaku. Me këtë rast,

Sogojeva - Dërmaku e ka informuar Konjufcën për gjendjen aktuale në Agjencinë për Informim dhe Privatësi, për sfidat që e presin dhe për hapat për ngritjen e efikasitetit të punës së saj. Ndërsa kryetari

i Kuvendit të Kuvendit, Glauk Konjufca, ka uruar Krenare Sogojeva - Dërmaku për zgjedhjen e saj në krye të Agjencisë për Informim dhe Privatësi, duke i premtuar bashkëpunim dhe përkrahje institucionale.



dije se dy vdekjet e regjistruara në 24 orët e fundit në Deçan nuk kanë lidhje me helmimet e fundit që kanë ndodhur në këtë komunë. "Raportet e para që i kemi marrë të dielën kanë qenë shqetësuese. Pa asnjë rast fatal deri më tani, dy rastet e vdekjes që i referoheni s'kanë të bëjnë me rastet që po flasim", ka thënë Vitia.

Bashkë me ministrin Vitia, Deçanin e ka vizituar edhe drejtori i Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike, Naser Ramadani, i cili ka deklaruar se deri më tani analizat laboratorike nuk tregojnë se qytetarët e Deçanit mund të jenë të helmuar nga uji. Ai ka thënë se IKShPK-ja po monitoron edhe pistat e tjera të mundshme. "Rezultatet laboratorike që kanë dalë sot flasin se nuk kemi asnjë pistë të helmimit hidrik. Por, kjo nuk do të thotë se nuk ka infeksione hidrike. Por, kjo do të dalë pas analizave permanente të ujit dhe të analizave të pacientëve. Do të informohemi me kohë", ka thënë ai.

Ramadani ka treguar se janë duke bërë monitorimin e vazhdueshëm të situatës. "Të gjitha infeksionet që kanë të bëjnë qoftë me rrugë hidrike, ushqim apo infeksione të tjera janë nën monitorim. Gjithashtu, është në hulumtim edhe çështja e ujës së pijes dhe furnizimit me ujë të pijes i cili në vazhdimësi po monitorohet për cilësinë e ujit të pijes", ka deklaruar Ramadani.

Ndërsa drejtori i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Deçan, Selmon Berisha, ka treguar se numri



## Komuna e Deçanit ndan 5 000 euro për qytetarët e helmuar

Komuna e Deçanit ka ndarë 5 000 euro për qytetarët që dyshohen se janë helmuar nga uji i pijes. Kryetari i kësaj komune, Bashkim Ramosaj, ka treguar se ky vendim është marrë pas takimit emergjent me anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa. "Me propozimin tim, sot kemi mbajtur takim emergjent me anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, të cilët unanimisht votuan për ndarjen e shumës në vlerë prej 5 000.00 €, të cilat do të dedikohen për nevojat e terapisë së qytetarëve të cilët po përballen me epideminë e shfaqur ditët e fundit në komunën e Deçanit", ka shkruar Ramosaj në profilin e vet në "Facebook".

i pacientëve që po dyshohet se janë helmuar deri më tani në Deçan është rreth 1 500.

### Opozita kritikon qeverinë për reagim të vonuar

Partitë opozitare e kanë vlerësuar të

vonuar reagimin e qeverisë ndaj situatës në Deçan. Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka deklaruar se është i brengosur për neglizhencën e qeverisë ndaj situatës në Deçan. "Jam i shqetësuar me gjendjen e rëndë nëpër të cilën po kalojnë qytetarët e Deçanit. Helmimi i

qytetarëve të kësaj komune nuk është vetëm çështje e shëndetit publik, por edhe çështje e sigurisë nacionale dhe kërkon mobilizim të gjithëmbarshtëm të të gjitha niveleve të qeverisjes. Jam i brengosur edhe për neglizhencën e qeverisë qendrore, e cila me shumë vonesë po e trajton situatën, në kohën kur duhet të jetë plotësisht pranë qytetarëve të kësaj komune. Duhet të ndërmerren masa të shpejta për ruajtjen e shëndetit të qytetarëve të

Daut Haradinaj. Ai ka ftuar organet e drejtësisë që ta hetojnë në përpikëri shkakun e këtij helmimi masiv. "Gjatë gjithë kohës isha në kontakt me kryetarin e komunës së Deçanit dhe institucionet relevante për t'u informuar për gjendjen e krijuar tash e sa ditë në Deçan, ku qindra qytetarë janë helmuar nga uji i pijes. Reagimi i institucioneve qendrore është vonuar dhe, si pasojë, sot Deçani ka shpallur gjendje



dëmtuar, mes të tjerash, duke siguruar ilaçe, staf shëndetësor shtesë, si dhe ujë të pijes të sigurt", ka shkruar Krasniqi në profilin e tij në "Facebook".

Të vonuar reagimin e institucioneve qendrore e ka quajtur edhe kandidati për kryetar të Prishtinës nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK),

emergjente.

Ftoj prokurorinë/hetuesinë dhe të gjitha kapacitetet e tjera shtetërore që të hetojnë në përpikëri shkakun e këtij helmimi masiv. Qytetarëve të prekur u dëshiroj shërim sa më të shpejtë", ka shkruar Haradinaj në profilin e vet në "Facebook".



## Asnjë i vdekur dhe tetë raste të reja me Covid në Kosovë

PRISHTINË, 13 KORRIK (ER) - Ministria e Shëndetësisë (MSh) ka njoftuar se gjatë 24 orëve të fundit në Kosovë nuk është raportuar asnjë rast i të vdekurit me Covid. Po ashtu, MSh-ja ka njoftuar se gjatë kësaj periudhe janë paraqitur tetë raste të reja me Covid.

"Në 24 orët e fundit janë dhënë 6 503 doza të vaksinës kundër Covid-19. Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 270 641 doza të vaksinës. Deri më sot 72 476 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë. Nga 2 133 testime, tetë qytetarë kanë

rezultuar pozitivë me virusin Covid-19. Gjatë 24 orëve të fundit nuk është shënuar asnjë rast i vdekjes. Sot janë shëruar 32 qytetarë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve është 105 495. Në total numri i rasteve aktive është 108", ka njoftuar MSh-ja.



AMRI I ANCA PËR

## Ambasada e ShBA-së: Të zhvendosurit kanë të drejtë të kthehen në shtëpi

PRISHTINË, 13 KORRIK (ER) - Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Kosovë ka ftuar institucionet e vendit të angazhohen që personat e zhvendosur të kthehen në shtëpitë e tyre. Kjo ambasadë ka theksuar se ministrat dhe kryetarët e

komunave duhet ta lënë politikën anash dhe të bashkëpunojnë për të siguruar që të gjithë kosovarët të gëzojnë paqe dhe siguri. “Viktimat meritojnë drejtësi dhe personat e zhvendosur kanë të drejtë të kthehen në shtëpi. Ministra dhe

kryetarë komunash, ju lutemi, lëreni politikën mënjanë dhe bashkëpunoni për të siguruar që të gjithë kosovarët të gëzojnë paqe dhe siguri, të lirë nga ngacmimi dhe frikësimi” është thënë në njoftimin e Ambasadës Amerikane.



# Prokuroria e Speciales propozon t'i vazhdohet paraburgimi Salih Mustafës, mbrojtja kërkon lirimin e tij



PRISHTINË, 13 KORRIK - Njëpërmjet parashtrësave për rishikim të masës së paraburgimit drejtuar trupit gjykues, përderisa Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) ka kërkuar vazhdimin e paraburgimit për Salih Mustafën, mbrojtja ka kërkuar lirimin e tij nga kjo masë. Sipas ZPS-së, ekziston dyshimi i bazuar se i akuzuari ka kryer krime brenda juridiksionit të Kosovës në Hagë, ka rrezik të arratisjes, të ndërhyrjes te

dëshmitarët e viktimat, si dhe i akuzuari mund të kryejë krime. Ndërsa mbrojtja me parashtrësën e saj ka kundërshtuar të gjitha të lartcekurat e ZPS-së si dhe ka kërkuar që Mustafa të lirohet nga paraburgimi dhe, sipas saj, nëse gjykata e vlerëson të nevojshme, mund të vendosë çdo kusht të lirimin që e gjykon si të nevojshme dhe të përshtatshme. Gjykimi ndaj Salih Mustafës pritet të fillojë më 15 shtator 2021.

Më 28 tetor ish-epurori i UÇK-së, Salih Mustafa, është deklaruar i pafajshëm për katër akuzat e ngritura ndaj tij nga Specialja. Më 28 shtator Salih Mustafa nuk kishte pranuar të deklarohet për akuzat që lidhen me krime lufte në Kosovë. Mustafa është i arrestuari i parë nga Specialja. Më 12 qershor 2020 është konfirmuar aktakuza ndaj tij, kurse arrestimi i tij u bë më 24 shtator. Në po të njëjtën ditë ai është transferuar në objektin e paraburgimit në

Hagë. Më 24 shtator ishin bërë publike edhe aktakuza ndaj Mustafës. “Aktakuza e konfirmuar përcakton se afërsisht midis 1 prillit 1999 dhe 19 prillit 1999, në një kompleks ndalimi në Zllash, Kosovë, u kryen krimet e ndalimit arbitrar, trajtimit mizor dhe të torturës kundër të paktën gjashtë personave. Gjithashtu, në aktakuzë thuhet se në një datë midis 19 prillit 1999, ose rreth kësaj date, dhe rreth fundit të prillit 1999, në atë vendndodhje

u vra një i ndaluar”, ka njoftuar Gjykata Speciale nëpërmjet një komunikate. Është bërë me dije se në aktakuzën e konfirmuar Salih Mustafa akuzohet në kuadër të formave të ndryshme të përgjegjësisë penale, për: ndalim arbitrar, trajtim mizor, torturë dhe vrasje të paligjshme si krime lufte të kryera në kontekstin e konfliktit të armatosur jo ndërkombëtar në Kosovë, ose në lidhje me atë konflikt.

## Dënohet me 16 vjet burgim e akuzuara për vrasjen e 57-vjeçarit në Malishevë

GIJAKOVË, 13 KORRIK - Gjykata Themelore në Gjakovë e ka dënuar me 16 vjet burgim Nafije Rrafshin, e akuzuar për vrasjen e tanimë të ndjerit Sefer Berisha në vitin 2018 në Malishevë. Sipas aktgjykimit të shpallur të martën nga gjykatësi Shaqir Zika, e akuzuara Rrafshi është dënuar

me 15 vjet e 6 muaj burgim për veprën penale të vrasjes, kurse me 1 vit burgim për veprën penale të armëmbajtjes pa leje. Ndaj saj është shqiptuar dënimi unik në kohëzgjatje prej 16 vjetësh burgim. Të njëjtës i është shqiptuar edhe dënimi plotësues, konfiskimi i armës, si dhe i është vazhduar

masa e paraburgimit deri në plotfuqishmëri të aktgjykimit, raporton “Betimi për drejtësi”. Kurse ndaj të akuzuarës Behare Nura, gjykata sipas detyrës zyrtare, ka bërë rikualifikimin e veprës penale, nga ajo e vrasjes në moslajmërim të veprës penale. Për këtë të fundit ajo

është dënuar me dy vjet burgim, kurse është liruar nga akuzat për veprën penale të armëmbajtjes pa leje. Në anën tjetër, i akuzuari i tretë në këtë rast, Granit Alushani, është dënuar me një vjet burgim për veprën penale të

armëmbajtjes pa leje. E akuzuara Rrafshi është ngarkuar edhe me shpenzimet e procedurës penale në vlerë 400 euro, kurse Nura dhe Alushani me nga 100 euro. Ata janë të obliguar edhe me pagesën e shumës prej 50 eurosh secili për kompensimin e viktimave të krimit.

# Milionat e Serbisë për fuqizimin e strukturave paralele në Kosovë

PRISHTINË, 13 KORRIK (ER) - Serbia nga buxheti i vet për vitin 2021 ka ndarë 91.8 milionë euro për financimin e institucioneve paralele dhe aktiviteteve të saj në Kosovë. Për struktura ilegale paralele të Serbisë në Kosovë në fushën e politikës, sigurisë, arsimit, shëndetësisë, ekonomisë dhe financave, është biseduar javën e kaluar në Bruksel midis përfaqësuesit të Kosovës dhe Serbisë në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve.

Besnik Bislimi, zëvendëskryeministër i Kosovës dhe kryenegociator në procesin e dialogut me Serbinë, duke komentuar takimin e Brukselit, kishte deklaruar përmes një postimi në "Facebook" se Serbia "jo që ka punuar në shuarjen e këtyre institucioneve, por i ka fuqizuar të njëjtat".

"Kam konstatuar se këto struktura Serbia nuk është duke i ngritur pa ndonjë arsye dhe që ata kanë si synim legalizimin e të njëjtave përmes asociacionit", ka thënë Bislimi më 12 korrik.

Po të njëjtën ditë, Petar Petkoviç, shef i Zyrës për Kosovën i Qeverisë së Serbisë dhe udhëheqës i delegacionit të Serbisë për dialogun me Kosovën, gjatë qëndrimit të tij në Zvečan, ka deklaruar para mediave se Bislimi "nuk e ka përmendur një gjë të tillë gjatë takimit në Bruksel".

Strukturat paralele të Serbisë në Kosovë vazhdojnë të ekzistojnë, ndonjëse një pjesë e tyre janë shuar vetëm në formë nominale, vlerësojnë përfaqësues të Institutit Demokratik të Kosovës dhe të organizatës joqeveritare "Qendra Humane në Mitrovicë".

## Heshtja e institucioneve për "pozitat fiktive"

Eugen Cakolli nga Instituti Demokratik i Kosovës ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se deklarimet për çështjen e strukturave paralele nga ana e zëvendëskryeministrit Bislimi i konsideron si deklarime në një format shabllon. Sipas tij, në rastin e shëndetësisë dhe të arsimit nuk bëhet fjalë vetëm për struktura paralele por, siç thotë ai, ato janë të vetmet në komunat me shumicë serbe të cilat funksionojnë sipas sistemit të Serbisë për shkak se atje nuk ka fare struktura të këtyre fushave sipas sistemit të Kosovës dhe se Kosova nuk ka bërë përpjekje që ta shtrijë juridiksionin e saj në këto dy fusha.

Megjithëse, sipas tij, strukturat e sigurisë dhe të drejtësisë janë shuar në formë nominale, në nivelin komunal ekzistojnë mjaft struktura paralele dhe ato veprojnë sipas juridiksionit të Serbisë. Komunat paralele, siç thotë ai, përbëjnë shembullin më të dukshëm të mosrespektimit të Marrëveshjes për shuarjen e strukturave paralele. "Serbia është më se e qartë që vazhdon të ketë

ndikim të madh dhe vijon të ketë sistem gati se paralel të nivelit lokal, me paradoksin që kryetarët e zgjedhur në mënyrë legjitime nga vota e qytetarëve, përmes rregullave të Kosovës, vijnë që të kenë një pozitë fiktive edhe në kuptimin e strukturave paralele të Serbisë. Institucionet tona deri më tani në heshtje e kanë toleruar një situatë të tillë, duke mos ndërmarrë thuarje asgjë dhe duke i bërë të brishta, në kuptimin formal, institucionet tona që ekzistojnë në veri të vendit", ka thënë Cakolli.

Ndërsa Verolub Petroniq nga organizata joqeveritare "Qendra Humane në Mitrovicë", në një bisedë për "Radion Evropa e Lirë", ka thënë se shumica e kryetarëve të komunave me shumicë serbe, të cilët i kanë fituar ato pozita në zgjedhjet e organizuara në sistemin e Kosovës, mbajnë edhe pozita udhëheqëse në organet e përkohshme të Serbisë, të cilat nga autoritetet e Kosovës konsiderohen paralele. Por, sipas tij, autoritetet e Kosovës nuk kanë bërë asgjë që kjo gjendje të ndryshojë dhe, siç thotë ai, kanë lënë të kuptohet që e kanë miratuar në heshtje këtë situatë. "Këtë e kanë ditur të gjithë ish-presidentët, ish-kryeministrat dhe kryetarët e Kuvendit dhe deputetët. Pra, ky nuk është kurrfarë sekret. Në mënyrë të heshtur Kosova e ka dhënë miratimin për një gjë të tillë. Kanë pasur të drejtë (autoritetet e Kosovës) që kur janë mbajtur zgjedhjet lokale, të kërkojnë dhe të thonë që këta nuk janë adekuatë që të jenë në listat zgjedhore, sepse ata ndodhen në pozita udhëheqëse në disa organe të përkohshme. Por, ata nuk e bënë këtë edhe pse e kanë ditur këtë rrefim", është shprehur Petroniq.

## Asociacioni, vetëm pas shuarjes së strukturave paralele?

Zëvendëskryeministri i Kosovës, Besnik Bislimi, ka shkruar në llogarinë e vet në "Facebook", se vetëm atëherë kur në Kosovë "të mos funksionojë asnjë strukturë paralele serbe, kur nuk do të ketë financim ilegal nga Serbia dhe kur askush në Evropë të mos e kontestojë sovranitetin dhe integritetin territorial të Kosovës, mund të diskutohet seriozisht për modalitetet më të përshtatshme për mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të minoriteteve".

Por, shefi i Zyrës për Kosovën i Qeverisë së Serbisë, Petar Petkoviç, ka theksuar që nuk po e kupton zëvendëskryeministrin e Kosovës, Besnik Bislimi. "Së pari, nuk e kam të qartë se për cilat komuna dhe institucione paralele është duke menduar Bislimi, kur ne jemi në vendin tonë, kur ne kemi institucionet dhe komunat tona, të cilat janë të vjetra disa dekada, por edhe institucione që janë të vjetra



për shumë shekuj dhe askënd nuk e rrezikojmë", ka thënë Petkoviç. Në anën tjetër, Eugen Cakolli nga Instituti Demokratik i Kosovës ka vlerësuar se çështja e shuarjes së tërësishme të strukturave paralele në Kosovë, si zbatim i marrëveshjeve të arritura më parë, duhet të diskutohet ndërmjet palëve në dialogun e Brukselit. "Për më tepër, besoj se Kosova bën mirë që e ndërlihd formimin e Asociacionit me shuarjen e këtyre strukturave. Përndryshe, ky do të ishte vetëm legjitimim i një situatë faktike që është në terren. Pra, ofrimi i kompetencave ekzekutive të Asociacionit (të Komunave me Shumicë Serbe), në shumicën e sektorëve ku Serbia ka struktura paralele, do të nënkuptonte, në një formë, legalizim dhe legjitimim të pushtetit efektiv që Serbia ushtron në një pjesë të territorit, sidomos në këto katër komuna veriore, por pa i anashkalluar edhe gjashtë komunat e tjera që ndodhen në jug të vendit", ka thënë Cakolli.

Kurse Verolub Petroniq nga "Qendra Humane në Mitrovicë" ka thënë se strukturat paralele serbe në Kosovë gravitojnë në Zyrën për Kosovën në Qeverinë e Serbisë. Ai shpreh mendimin që kjo zyrë "do të jetë një Ministri e Punëve të Jashtme ose një lloj përfaqësie konsullore e Serbisë në Kosovë". "Më duket që në rast se arrihet një marrëveshje obliguese apo pajtim, qysh do që të quhet, me siguri që të gjitha ato struktura që punojnë në Zyrën për Kosovën, do të jenë një lloj ndërlihdjeje ndërmjet Serbisë dhe institucioneve të përkohshme në Kosovë ashtu siç i quajnë në Beograd", ka thënë Petroniq.

Për vitin 2021 Serbia ka ndarë 91.8 milionë euro për Kosovën. Pjesa më e madhe e këtij buxheti, 67.7 milionë euro, janë dedikuar për Zyrën për Kosovën të Qeverisë së Serbisë. Sërish pjesa më e madhe e kësaj shume që merr kjo zyrë, rreth 43.7 milionë euro, shkon për ta mbështetur funksionimin e institucioneve paralele dhe

organizatave të tjera në Kosovë, ndërsa 23.6 milionë euro shkojnë për të mbështetur përmirësimin e cilësisë së jetës së popullatës serbe dhe joshqiptare.

Rreth 2.59 milionë euro janë ndarë për "mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, mbështetjen e kishës ortodokse serbe dhe aktivitetet kulturore".

Fondet e Serbisë për Kosovën ndahen jo vetëm përmes kësaj zyre, por edhe përmes ministrive të caktuara. Përmes Ministrisë së Arsimit të Serbisë ndahen rreth 23.8 milionë euro për ta mbështetur punën e të ashtuquajturit Universitet i Prishtinës me qendër në Mitrovicën e Veriut, i cili punon sipas sistemit arsimor të Serbisë. Ministria e Kulturës e Serbisë ndan rreth 87 mijë euro për ta mbështetur informimin e qytetarëve në gjuhën serbe.

Përmes kabinetit të ministrit pa portofol, të ngarkuar me inovacionin dhe zhvillimin teknologjik, ndahen 237 mijë euro për ta mbështetur përmirësimin e kapacitetit të inovacionit. Gjithashtu, financohen edhe të ashtuquajturat qarqe administrative. Qarku administrativ i Kosovës merr rreth 143 mijë euro, qarku administrativ i Mitrovicës së Kosovës merr rreth 100 mijë e 250 euro dhe qarku administrativ i Anamoravës së Kosovës merr rreth 82 mijë e 800 euro. Drejtoria për Bashkëpunim me Kishat dhe Komunitetet Fetare ndan rreth 540 mijë e 425 euro për "mbështetje për klerikët dhe manastiret në Kosovë".

## Udhëheqësit komunalë dhe deputetët me dy pozita

Se kryetarët e komunave me shumicë serbe, që janë integruar në sistemin e Kosovës, bartin funksione edhe në strukturat paralele, ka mjaft shembuj. Të

gjithë ata janë nga Lista Serbe, e cila është themeluar dhe gëzon mbështetjen nga Beogradi zyrtar. Lista Serbe në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të Kosovës, të mbajtura më 14 shkurt, ka fituar dhjetë ulëse në Kuvendin e Kosovës. Të dhjetë komunat me shumicë serbe në Kosovë po ashtu drejtohen nga përfaqësues të Listës Serbe. Për shembull, Zoran Todiç është kryetar i komunës së Leposaviqit sipas sistemit të Kosovës, njëkohësisht është edhe kryetar i organit të përkohshëm të Leposaviqit, sipas sistemit të Serbisë.

Sërgjan Vulloviç është kryetar i Komunës së Zubin Potokut sipas sistemit të Kosovës, por edhe kryetar i organit të përkohshëm të Zubin Potokut sipas sistemit të Serbisë. Bratislav Nikoliç, kryetar i Komunës së Shtërpcës sipas sistemit të Kosovës, është njëkohësisht edhe koordinator në organin e përkohshëm të Shtërpcës sipas sistemit të Serbisë. Funksione të dyfishta, sipas sistemit të Kosovës dhe atij të Serbisë, bartin edhe disa nga deputetët e Listës Serbe në Kuvendin e Kosovës. Për shembull, Ivan Todosijević është deputet në Kuvendin e Kosovës nga radhët e Listës Serbe, njëkohësisht kryetar i organit të përkohshëm të Zveçanit. Slavko Simiq është deputet në Kuvendin e Kosovës nga radhët e Listës Serbe dhe njëkohësisht kryeshf i qarkut të Mitrovicës së Kosovës sipas sistemit të Serbisë. Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Serbisë, organi i përkohshëm i njësisë së vetëqeverisjes lokale kryen detyrat dhe kompetencat e kuvendit dhe organeve ekzekutive të njësisë së vetëqeverisjes lokale "deri në konstituimin e kuvendit dhe zgjedhjen e organeve ekzekutive". Ndryshe, takimi i ri në mes të kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti dhe presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, do të mbahet të hënën më 19 korrik në Bruksel.

## Punëtorët e ATK-së sot hyjnë në grevë

PRISHTINË, 12 KORRIK (ER) - Sindikata e Punëtorëve e Administratës Tatimore të Kosovës (SPATK) ka njoftuar se pasi Ministria e Financave nuk ka marrë për bazë kërkesat e saj, sot (e mërkurë) do ta rifillojnë grevën, duke i ndërprerë për tri orë të gjitha shërbimet për tatimpaguesit. Krijimi i kushteve të punës, propozim-ndryshimi i statusit të Administratës Tatimore të Kosovës dhe kompensimet e

tjera të shpenzimeve janë kërkesat e punëtorëve të ATK-së. "Krijimi i kushteve të punës, propozim-ndryshimi i statusit të Administratës Tatimore të Kosovës dhe kompensimet e tjera të shpenzimeve janë kërkesat e punëtorëve të ATK-së. Sindikata e Punëtorëve e Administratës Tatimore të Kosovës, pas ngritjes së kërkesave drejtuar Ministrisë së Financave dhe pas ripërsëritjes së dërgimit të shkresës së fundit

më 9 qershor 2021, përmes së cilës i është dhënë afat prej 30-ditësh, meqë nuk është pranuar përgjigje në lidhje me kërkesat e adresuara, njofton që ditën e mërkurë, më 14 korrik 2021, do ta vazhdojë grevën e pezulluar të datës 20 maj 2021. Greva do të fillojë nga ora 9:00 deri 12:00, duke i ndërprerë të gjitha shërbimet për tatimpaguesit", ka njoftuar SPATK-ja. Greva do të mbahet në të gjitha

drejtoritë e Administratës Tatimore të Kosovës. Arsyet për mbajtjen e kësaj greve janë sqaruar edhe në njoftimet paraprake. "Kërkesat tona të adresuara janë si në vijim: krijimi i kushteve të punës, propozim-ndryshimi i statusit të Administratës Tatimore të Kosovës, kompensimet e tjera të shpenzimeve (sipas kërkesave paraprake). Greva është e drejtë e garantuar me Kushtetutë dhe do të vazhdojë



duke u mbështetur edhe në Ligjin nr. 04/L-011 për organizimin sindikal në Kosovë, Ligjin për Greva nr. 03/L-200, si dhe duke u bazuar në statutin e SPATK-së", ka njoftuar kjo sindikatë.

## BE-ja: Kosovës i nevojiten reformat në ekonomi për rritjen e konkurrencës

PRISHTINË, 13 KORRIK (ER) - Kosovës i duhen reforma në fushat ekonomike, sociale dhe shëndetësore që janë pengesë për rritjen dhe konkurrueshmërinë. Kështu është thënë në deklaratën e përbashkët për dialogun ekonomik dhe financiar të Këshillit të Bashkimit Evropian (BE). Sipas deklaratës së këtij këshilli, pandemia ka ndikuar në rritjen ekonomike të Kosovës. "Brenda afateve të kërkuara është siguruar ndihmë mjekësore dhe financiare për luftimin e pandemisë Covid-19. Palët u pajtuan që këtë vit dialogu për



politika ekonomike të fokusohet në mbështetjen e rimëkëmbjes afatmesme ekonomike dhe

qëndrueshmërinë e rajonit, tekta përkohësisht, përmes masave transparente fiskale dhe

financiare, vazhdohet puna për zbutjen e ndikimit të pandemisë mbi rritjen, punësimin dhe kohezionin social. Sa i përket situatës ekonomike të Kosovës për vitin 2020, rritja ekonomike u thye në recesion të konsiderueshëm për shkak të mbylljeve të lidhura me pandeminë dhe kufizimeve të udhëtimeve. Në të njëjtën kohë pengesat madhore strukturore vazhdojnë të jenë sfida ndaj rritjes dhe konkurrueshmërisë", është thënë në deklaratë.

Më tutje, BE-ja ka thënë se Kosova duhet ta trajtojë formalizmin e

ekonomisë. "Sa i përket rritjes së konkurrueshmërisë dhe rritjes afatgjatë dhe gjithëpërfshirëse, Kosova duhet ta trajtojë formalizmin e ekonomisë dhe konkurrueshmërinë e ulët të sektorit privat, t'i shfrytëzojë potencialet për energji të ripërtërishme dhe për kursim të energjisë dhe ta hapë plotësisht tregun e energjisë si dhe ta përmirësojë cilësinë dhe rëndësinë e sistemit arsimor për rritjen e punësimin dhe për zbutjen e mospërputhjeve të shkathtësive", është thënë në deklaratën e Këshillit të BE-së.

## Rikthehet furnizimi me ujë në Deçan, 'Hidrodrini' bën thirrje të mos pihet uji

PRISHTINË, 13 KORRIK (ER) - Kompania Rajonale e Ujësjellësit në rajonin e Dukagjinit "Hidrodrini" ka njoftuar se ka kthyer furnizimin me ujë të pijshëm në fshatrat e Deçanit, ku qytetarë të shumtë dyshohet se u helmuan. Megjithatë, kjo ndërmarrje ka bërë thirrje që ky ujë të mos pihet. Që nga e shtuna mbi 1 500

qytetarë nga fshatrat Prejlep, Rastavicë, Irzniq, Glogjan, Shaptej, Gramaqel, Baballoq, Ratishë dhe Jasiq i Ri kanë kërkuar trajtim shëndetësor. Sipas KRU "Hidrodrinit", analizat e bëra të këtij uji flasin se ai është brenda normave, duke rezultuar në kufij të lejuar, sipas standardeve evropiane. "Ky fakt sa e qetëson gjendjen dhe e vë në pah të vërtetën po aq

edhe duhet ta rrisë përkushtimin dhe vëmendjen e autoriteteve respektive, qytetarëve, mediave dhe shoqërisë se çka tjetër mund të ketë ndikuar në shëndetin qytetar. Përkundër se rezultatet e mostrave të ujit të nxjerra nga IKShPK-ja kanë rezultuar në pajtim me kushtet dhe standardet e pijes dhe janë publikuar, KRU 'Hidrodrini' që nga çasti i parë e deri më sot ka



vazhduar ta mbajë të ndërprerë furnizimin me ujë për fshatrat në fjalë si masë siguroese e mëtejme. Sot, pas takimit të Shtabit

Emergjent Komunal të Deçanit, është vendosur që nga ora 13:00 të rikthehet furnizimi nga sistemi i ujësjellësit për zonën në fjalë. Përkundër këtij vendimi, të përbashkët të shtabit emergjent, KRU 'Hidrodrini' rekomandon që uji sërish mos të përdoret për pije, por vetëm për nevoja sanitare dhe higjienike deri në një vendim të ardhshëm", ka njoftuar KRU "Hidrodrini".

## Rizvanolli: Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik, prioritet i ministrisë

PRISHTINË, 12 KORRIK (ER) - Për rastin e fundit të helmimit të qytetarëve me ujë në Deçan, ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, ka thënë se janë në kontakt të vazhdueshëm me ndërmarrjen "Hidrodrini" lidhur me gjendjen e krijuar këto ditë atje. Rizvanolli gjatë raportimit në Komisionin për Ekonomi, duke iu përgjigjur kryetarit të këtij komisioni, Ferat Shala, për atë se çfarë ka ndodhur me rreth 900 qytetarë, ka theksuar se do ta vizitojnë ndërmarrjen "Hidrodrini" për të parë nga afër

lëshimet e mundshme që mund të kenë ndodhur dhe çuar deri te helmimi i qytetarëve. Gjatë raportimit për planin e punës ajo ka theksuar se prioritet dhe qëllim i ministrisë që drejton mbetet krijimi i kushteve për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik përmes zhvillimit të teknologjisë së informacionit dhe energjisë së pastër. Më tutje, Rizvanolli ka vënë theksin në sfidat e kësaj ministrie dhe të qeverisë lidhur me gjendjen e rëndë të disa ndërmarrjeve publike. Për shërbimet e ujit në veri të

Mitrovicës ajo ka thënë se kjo është një sfidë e krijuar tash e mbi 20 vjet. Duke iu përgjigjur kryetarit të Komisionit për Ekonomi, Ferat Shala, Rizvanolli ka thënë se në vitin e ardhshëm do të bëhet dekomisionimi i pjesëve jofunksionale të TC "Kosova A". Për këto dekomisionime, kryetari Shala ka theksuar se nevojitet një studim i fizibilitetit nëse mbështetet kjo nga IPA III dhe nuk ka përgatitje për këtë çështje. Shala ka ngritur edhe çështjen e fondit të MCC në vlerë prej 200 milionë eurosh lidhur me



eficiencën e energjisë. Ndërsa ministrja Rizvanolli ka theksuar se ky fond nuk

parashihet për këtë sektor, por për gazin dhe subvencionimin e sektorit privat.

## Kastrati: Biznese të reja po i shtohen Kamenicës

KAMENICË, 13 KORRIK - Kryetari i komunës së Kamenicës, Qëndron Kastrati, së bashku me zyratën nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Diasporës, Qëndresa Kastrati, kanë nënshkruar kontratë me qytetaren dhe sipërmarrësen Shukrije Shkodra për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës. Me këtë rast, Kastrati është shprehur i lumtur që çdo ditë e më shumë Kamenicës po i shtohen biznese të reja falë punës dhe angazhimit të zyrtarëve për dhënien e tokës së komunës në shfrytëzim si dhe

vullnetit të të gjithë qytetarëve për zhvillimin e veprimtarive të ndryshme. "Biznese të reja po i shtohen Kamenicës pas dhënies së tokës në shfrytëzim nga komuna. Njëjtë po ndodh me 'Bio Enbli', përfaqësuar nga Shukrije Shkodra, ku planifikohen të mbillen plantacione me arra dhe lajthi", ka thënë Kastrati. Ndërsa Shukrije Shkodra ka falënderuar komunën për mundësinë e dhënë për realizimin e planit të biznesit. Në këtë pronë të dhënë në shfrytëzim është planifikuar ngritja e një plantacioni me arra dhe lajthi.



## Nënshkruhet kontrata për shfrytëzimin e Qendrës Rinore në Drenas



DRENAS, 13 KORRIK (ER) - Kryetari i komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, i shoqëruar nga nënkryetari Arben Shala dhe drejtoresha e Kulturës, Rinisë e Sporteve, Shqipe Zogu, të martën kanë pritur në takim përfaqësuesin e "Flutura Academy" Bekim Ahmetaj dhe Visar Krelani.

Në këtë takim është nënshkruar edhe kontrata në mes të kryetarit Lladrovci dhe Bekim Ahmetajt për shfrytëzimin e Qendrës Rinore në Drenas, ku në kuadër të kësaj kontrate do të ketë karakterin edukativo-arsimor të

edukimit.

Ne bazë të kësaj kontrate, "Flutura Acedemy" do ta shfrytëzojë objektin e Qendrës Rinore në Drenas në një periudhë njëvjeçare, ku gjatë kësaj kohe do të organizohen trajnime/kurse dhe aktivitete të tjera rinore. Të gjitha trajnimet/kurset dhe aktivitetet e tjera do të jenë pa pagesë për fëmijët e komunës së Drenasit nga klasa e parë deri në klasën e dymbëdhjetë, si dhe përgatitjen e të rinjve për tregun e punës me kushte të volitshme dhe profesionale.

## Kuvendi Komunal i Podujevës dërgon në shqyrtim publik hartën zonale

Podujevë, 13 korrik - Kuvendi i komunës së Podujevës ka mbajtur të martën një mbledhje të jashtëzakonshme në të cilën ka miratuar propozimin për ta dërguar në shqyrtim publik Projekt-hartën Zonale të Komunës së Podujevës 2020-2028.

Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit (DPUMM), Bujar Hasani, ka thënë se Projekt-propozimi për Hartën Zonale të Komunës së Podujevës ka ardhur në Kuvend për të shkuar në shqyrtim publik në afat të përshpejtuar prej 15-ditësh pas marrjes së konfirmimit

nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI). Ai ka thënë se Harta Zonale është një ndër dokumentet më të rëndësishme të komunës dhe është trajtuar me kujdes të veçantë në mënyrë që në fund ta kemi një dokument funksional dhe që u ofron zgjidhje në shumë çështje qoftë në aspektin zhvillimor dhe infrastrukturor.

Në këtë mbledhje kanë qenë të pranishëm kryetari i Podujevës, Shpejtim Bulliqi, nënkryetarja Marigona Lahu dhe drejtorët e kësaj komune.



## Skenderaj organizon aktivitete të ndryshme për muajin e diasporës

SKENDERAJ, 13 KORRIK (ER) - Kryetari i komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka bërë me dije se nga 16 korriku deri më 16 gusht do të organizojnë aktivitete të ndryshme në kuadër të muajit të diasporës. "Pas një periudhe të vështirë pandemike, e cila

pamundësoi ardhjen tuaj në vendlindje dhe pritjen dinjitoze për ju, këtë vit po e vazhdojmë traditën e pritjes me zemër për ju që mbani gjallë ekonominë, familjet dhe shtetin tonë. Nga data 16 korrik e deri më 16 gusht do të organizojmë për ju muajin e diasporës, me

aktivitete të shumta kulturore, argëtuese dhe sportive", ka njoftuar Jashari. Ai ka thënë se në sheshin "Adem Jashari" do të organizohet mbrëmje muzikore me këngëtarët më eminentë të estradës sonë, në shenjë falënderimi dhe mirënjohje

bashkëqytetarët që jetojnë në diasporë, për kontributin e jashtëzakonshëm dhënë në luftën e përbashkët për liri e pavarësi dje dhe rritjen e zhvillimit ekonomik të shtetit sot. "Mirë se vjen diaspora jonë! Ju presim me zemër!", ka thënë Jashari.





GABRIEL GARCÍA MÁRQUEZ

# VETMIA E AMERIKËS LATINE

## LIGJËRATA E NOBELIT, 8 DHJETOR 1982

Antonio Pigafetta, një navigator florentinas, që shoqëroi Magelanin në udhëtimin e tij të parë përreth botës, me rastin e kalimit nëpër tokat tona jugore të Amerikës, bëri një shkrim shumë të saktë që, megjithatë, i ngjan një aventure në imagjinatë. Në të ai kishte shënuar se kishte parë derra me kërhiza në kofshë, zogj pa kthetra që lëshonin vetë mbi shpinë të qifteve të tyre dhe të tjerë që u ngjanin pelikanëve pa gjuhë, me sqepa si lugë. Ai shkroi se kishte parë një krijesë bastarde me kokën dhe veshët e një mushke dhe me trup deveje, këmbët e një dreri dhe jelen e një kali. Ai kishte përshkruar se si kishte reaguuar vendësi i parë që kishte takuar në Patagonia, me të parë pasqyrën, me ç'rast ai vigan i pasionuar kishte humbur toruan, ishte terrorizuar nga imazhi i fytyrës së vet. Ky libër i shkurtër dhe fasciuës, i cili që atëherë mbolli farën e romaneve tona të sotme, nuk është assesi një përshkrim tronditës i realitetit tonë në atë kohë. Kronikat e Indisë na kanë lënë shumë të tjera. El Dorado, ishulli ynë iluzor aq shumë i dëshiruar, është paraqitur në harta të shumta për shumë vite me radhë, me vende dhe forma të

ndryshme për ta kënaqur fantazinë e hartografëve. Në kërkimin e tij për fontanën e rinisë së përjetshme, Alvar Nunhez Kabeza de Vaka mistik eksplori tetë vjet veriu e Meksikës, në një ekspeditë zhgënjyese, anëtarët e së cilës hëngrën njëri-tjetrin dhe prej të cilëve vetëm pesë u kthyen, nga gjashtëqind sa kishin marrë atë udhë. Një nga misteret e shumta të pazbuluara të asaj epoke është ajo e njëmbëdhjetë mijë mushkave, secila prej tyre e ngarkuar më njëqind funta ar, që Cuzco i kishte lënë dikur për ta paguar haraçin e Atahualpas dhe që kurrë nuk kishte arritur në cak. Më vonë, në kohët koloniale, pulat shiteshin në Cartagena de Indias, të rritura në toka lymore, katëket e të cilave mbanin brenda kokra të vogla ari. Lakmia e kërkuesve të arit na ka shoqëruar deri në ditët tona. Deri vonë në shekullin e fundit, një mision gjerman i emëruar për ta studiuar ndërtimin e një hekurudhe tejoqeanike matanë Ishmit të Panamasë konkludoi se projekti ishte i realizueshëm me një kusht: që binarët të mos bëheshin nga hekuri, që nuk ishte me bollëk në rajon, por nga ari. Pavarësia jonë nga dominimi spanjoll nuk na shpëtoi nga çmendia. Gjenerali Antonio Lopez de Santana, tri herë diktator i

Meksikës, organizoi një funeral madhështor për këmbën e tij të djathtë që e kishte e humbur në të ashtu-quajturën Luftë e Pastave. Gjenerali Gabriel Garcia Moreno sundoi Ekuadorin për gjashtëmbëdhjetë vjet si monark absolut; kur vdiq, kufoma i rrinte ulur në fronin presidencial, e veshur në uniformë të plotë dhe me medaljet e shumta në gjoks. Gjenerali Maksimiliano Hernandez Martinez, despoti teozofik, shpiki një lavjerrës për ta hetuar helmin në ushqimin e tij, kurse fenerët e rrugëve i kishte veshur me letër të kuqe për ta penguar epideminë e etheve të fruthit. Shtatorja e gjeneralit Francisko Moraz, e ngritur në sheshin kryesor të Tegucigalpas është, në të vërtetë, e Marshal Neit, e blerë në një depo skulpturash të dorës së dytë në Paris. Para njëmbëdhjetë vjetësh kiliani Pablo Neruda, një nga poetët më të mëdhenj të kohës sonë, ftilloi këtë auditor me fjalën e tij. Që nga atëherë evropianët e vullnetit të mirë - dhe nganjëherë edhe ata me vullnet të keq - janë habitur, me forcë gjithnjë më të madhe, nga lajmet e mbinatyrshe të Amerikës Latine, asaj mbretërie të pafund të burrave të përhumur dhe të grave historike, kryeneçësia e pambarim e të cilave davaritet në

legjendë. Nuk kemi pasur asnjë çast pushimi. Një president prometheas, i mbyllur në pallatin që digej, vdiq duke luftuar kundër një ushtrie të tërë, i vetëm; dhe, dy aksidente të dyshimta ajrore, që ende s'janë sqaruar, këputën jetën e një presidenti tjetër zemërmadh dhe atë të një luftëtari për demokraci, i cili ia kishte kthyer dinjitetin popullit të vet. Kanë ndodhur pesë luftëra dhe shtatëmbëdhjetë grusht shtete; lindi një diktator diabolik, i cili po zbaton, në emër të Zotit, etnocidin e parë latino-amerikan të kohës sonë. Në ndërkohë, njëzet milionë fëmijë latino-amerikanë kanë vdekur para se të mbushin një vit - më shumë nga ç'kanë lindur në Evropë që nga viti 1970. Ata që kanë humbur pa gjurmë për shkak të represionit numërojnë gati njëqind e njëzetmijë, që është sikur askush të mos kishte idenë se nga kanë humbur të gjithë banorët e Upsalas. Shumë gra shtatzëna të arrestuara kanë lindur në burgjet argjentinasë, ndërkohë që askush nuk di për ecejaket dhe identitetin e fëmijëve të tyre, të cilët fshehurazi u adoptuan apo u çuan në jetimore me urdhër të autoriteteve ushtarake ngaqë u përpoqën të ndryshonin këtë gjendje të gjërave, rreth dyqind mijë burra dhe gra kanë vdekur në tërë kontinentin

dhe mbi njëqind mijë kanë humbur jetën në tri vende të vogla fatkeqe të Amerikës Qendrore: Nikaragua, El Salvador dhe Guatemalë. Po të kishte ndodhur kjo në Shtetet e Bashkuara, figura gegjëse do të ishte një milion e gjashtëqind mijë vdekje të dhunshme për katër vjet. Një milion njerëz kanë ikur nga Kili, një vend me traditë mikpritjeje - do të thotë, dhjetë për qind e popullsisë së tij. Uruguai, një vend i vogël prej dy milionë e gjysmë banorësh, që e konsideronte veten vendi më i qytetëruar i kontinentit, ka humbur në mërgim çdo të pestin qytetar. Që nga viti 1979 lufta civile në El Salvador ka prodhuar nga një refugjat në çdo njëzet minuta. Vendi që do të mund të krijohet nga të gjithë refugjatët dhe emigrantët e detyruar të Amerikës Latine do të kishte një popullsi më të madhe se Norvegjia. Marr guximin të them se është ky realitet përtej masash dhe jo vetëm shprehja e tij letrare ka merituar vëmendjen e Akademisë Suedeze të Letrave. Një realitet jo nga letra, por një realitet që jeton brenda nesh dhe që përcakton çdo çast të vdekjeve tona të panumërta ditore, mes të cilave ky kolumbian bredhacak dhe nostalgjik përbën vetëm një shifër, të veçuar vetëm nga rasti. Poetët dhe lypësit,

muzikantët dhe profetët, luftëtarët dhe horrat, të gjitha krijesat e atij realiteti të shfrenuar, nuk është dashur të kenë shumë imagjinatë, ngaqë problemi ynë kyç ka qenë mungesa e mjeteve konvencionale për t'i bërë jetët tona të besueshme. Ky, miqtë e mi, është thelbi i vetmisë sonë.

Dhe nëse këto vështirësi, thelbin e të cilave e ndajmë, na pengojnë, është e kuptueshme që talentet racionale në këtë anë të botës, të ekzaltuara në kontemplimin e kulturave të veta, do të ishin gjetur pa mjete valide për të na interpretuar. Është më se e natyrsme që ata këmbëngulin të na matin me kutin që përdorin për vete, duke harruar se shkatërrimet e jetës nuk janë të njëjta për të gjithë dhe se kërkimi i identitetit tonë është po aq i rëndë dhe i përgjakshëm siç ka qenë edhe për ta. Interpretimi i realitetit tonë përmes mostrave që nuk janë tonat, shërben vetëm sa për të na bërë edhe më të panjohur, edhe më pak të lirë, edhe më shumë të vetmuar. Evropa e nderuar mbase do të mund të ishte më perceptivë po të përpjeqje të na shihte ne në të kaluarën e vet. Sikur të kujtonte se Londrës iu deshën treqind vjet për ta ndërtuar murin e parë të qytetit dhe treqind vjet të tjera për të pasur një peshkop; se Roma jetoi në një errësirë pasigurie për njëzet vjet, derisa një mbret etrusk e futi atë në histori dhe se Zvicra e sotme paqësore, që na gostit me djathërat e butë dhe me orët e këndshme, përgjaku Evropën me mercenarë deri në shekullin gjashtëmbëdhjetë. Madje edhe në kulmin e Renesancës, dymbëdhjetë mijë mercenarë të paguar nga ushtritë perando-rake plaçkitën dhe shkrëtëruan Romën, kurse tetë mijë banorë të saj i prenë me shpatë.

Nuk dua që t'i mishëroj iluzionet e Tonio Krogerit, ëndrrat e të cilit, për bashkimin e veriut të virgjër me jugun e pasionuar, gjetën ekzaltim këtu, para pesëdhjetë e tre vjetësh, nga Tomas Man. Por, besoj se ata evropianë mendjekthjellët, të cilët luftojnë, edhe këtu, për një atdhe më të drejtë dhe më human, do të na ndihmonin shumë më shumë sikur ta rishqyrtonin mënyrën se si na shohin ne. Solidariteti me ëndrrat tona nuk do të na bëjë të ndihemi më pak të vetmuar përderisa ai nuk përkthehet në akte konkrete të mbështetjes legjitime për të gjithë popujt që kanë iluzionin se kanë një jetë të tyre për distribuimin e botës.

Amerika Latine as nuk dëshiron dhe as që ka ndonjë arsye të jetë pion pa pasur një vullnet të vetin dhe as që është shprehje dëshire që kërkimi i saj për pavarësi dhe origjinalitet të bëhet aspiratë perëndimore. Megjithatë, përparimet e navigimit që kanë ngushtuar largësi të tilla midis Amerikave dhe Evropës duken, nga ana tjetër, sikur kanë vënë në pah largësinë tonë

kulturore. Përse, vallë, ai origjinalitet që na është njohur me aq gatishmëri në letërsi, po na mohohet me aq mosbesim në përpjekjet tona të rënda për ndryshim shoqëror? Pse të mendohet se drejtësia shoqërore që kërkojnë evropianët progresivë për vendet e tyre, nuk mund të jetë edhe synim i Amerikës Latine, me metoda të ndryshme për kushte jo të ngjashme? Jo: dhuna dhe dhembja e pamasë e historisë sonë janë rezultat i pabarazive shekullore dhe pikëllimit të papërshkruar dhe jo një komplot i përgatitur tre mijë liga larg shtëpisë sonë. Por, shumë liderë dhe mendimtarë evropianë kanë menduar kësaj, me mendje çilimiu të pleqve, të cilët kanë harruar teprimet e tyre rinore, sikur të mos jenë në gjendje të gjejnë ndonjë fat tjetër pos atij të jetës nën mëshirën e dy zotëve të mëdhenj të botës. Ky, miqtë e mi, është masa e vërtetë e vetmisë sonë.

Përkundër kësaj, ndaj shtypjes, grabitjes dhe braktisjes, ne përgjigemi me jetën. As përmbytjet as murtajat, as uria dhe as kataklizmet, madje as luftërat e pambarim shekull pas shekulli, nuk kanë qenë në gjendje ta mposhtin avantazhin këmbëngulës të jetës mbi vdekjen. Një avantazh ky që rritet dhe përshpejtohet: për çdo vit ndodhin shtatëdhjetë e katër milionë më shumë lindje sesa vdekje, një numër i mjaftueshëm i jetëve të reja për ta shtuar, çdo vit, popullsinë e Nju-Jorkut për shtatë herë. Shumica e këtyre lindjeve ndodhin në vendet me më pak resurse - përfshirë, natyrisht, ato të Amerikës Latine. Nga ana tjetër, vendet më prosperuese kanë arritur të akumulojnë forcë shkatërrimi sa për të zhdukur, për njëqind herë me radhë, jo vetëm qeniet njerëzore që kanë ekzistuar deri më sot, por edhe të gjitha qeniet e gjalla që kanë frymuar ndonjëherë në këtë planet fatkeq.

Në një ditë si kjo, mësuesi im, Uilliam Fokner, ka thënë: "Unë refuzoj ta pranoj fundin e njeriut". Nuk do të meritoja të qëndroja në këtë fron, që ishte i tij, sikur të mos isha plotësisht i vetëdijshëm se tragjedia kolosale që ai refuzoi ta njihje para tridhjetë e dy vjetësh, është tani, për herë të parë që nga fillimi i njerëzimit, asgjë më shumë se një mundësi e thjeshtë shkencore. Të ballafaquar me këtë realitet të tmerrshëm, që mund të jetë dukur vetëm si një utopi gjatë tërë kohës njerëzore, ne, shpikësit e tregimeve, që do të besojmë në çdo gjë, kemi të drejtë të besojmë se ende nuk është vonë që të vendosim për të tjerët se si do të vdesin, aty ku dashuria do të dëshmohej e vërtetë dhe lumturia e mundur, dhe ku racat e gjykuara në njëqind vjet vetmi do të kenë, përfundimisht dhe përjetësisht, një shans të dytë mbi tokë.

(Marrë nga numri i 11-të i revistës "Akademia")

# NYT më 1982: KGB ka organizuar të paktën tri përpjekje për puç në Shqipëri

Nga: Eric MARGOLIS  
(New York Times, 1982)

Shqipëria, vendi më pak i njohur evropian, mund të jetë skena e një ndryshimi drastik në ekuilibrin e fuqisë Lindje-Perëndim. Vlera strategjike e Shqipërisë, megjithëse harrohet praktikisht në Perëndim, është kuptuar plotësisht nga Moskë. Në afërsi të Jugosllavisë, Greqisë dhe Italisë, Shqipëria me dy porte të shkëlqyera të ujërave të thella, në Vlorë dhe në Durrës, dominon gadishullin Ballkanik dhe hyrjen në Detin Adriatik. Bregu italian është vetëm 50 milje larg, përtej ngushticës së Otrantos.

Në vitin 1961, Shqipëria u bë i vetmi vend që dëboi me sukses forcat "okupuese" sovjetike dhe një establishment pro-konsullor. Në atë kohë, lideri i partisë, Enver Hoxha, një admirues i madh i Stalinit, prishi papritmas të gjitha lidhjet me Moskën për shkak të programit të destalinizimit të Nikita S. Hrushovit. Rusët sapo ishin duke përfunduar një kompleks instalimesh detare dhe vendqëndrimesh nënujore për nëndetëse në ishullin e gurtë të Sazanit, i njohur si "Gjibraltari i Adriatikut", në portin e Vlorës. Sazani, dhe bazat e tij ajrore dhe logjistike shoqëruese në Shqipërinë kontinentale, do të kishin qenë baza pararojë, nga e cila Kremli do të përhapte ndikimin e vet në të gjithë Evropën Jugore dhe në Lindjen e Mesme.

Shqiptarët i morën të gjitha këto instalime, duke dëbuar mijëra këshilltarë sovjetikë dhe madje duke marrë dy nëndetëse. Megjithëse i indinjuar, Bashkimi Sovjetik nuk ishte në gjendje të organizonte një përgjigje efektive ushtarake sepse 21 vjet më parë, kur Flota e Gjashtë e Shteteve të Bashkuara mbizotëronte në Mesdhe, rusëve u mungonte forca ajrore dhe amfibe me rreze të gjatë veprimi.

Rusët nuk e kanë harruar këtë poshtërim nga një vend me 2.5 milionë banorë dhe modeli i veprimtarive antishqiptare të Moskës gjatë dy dekadave të fundit, tregon se rivendosja e kontrollit mbi Shqipërinë është një qëllim i rëndësishëm i strategjisë së madhe të Kremlinit. Provat e prekshme të interesit të Moskës për të përmbytur regjimin e Shqipërisë kanë qenë të qarta. KGB, duke përdorur një kolonë të gjerë të pestë pro-sovjetike në Shqipëri, ka organizuar të paktën tre përpjekje grushte shteti.

Sot, ngjarjet në Shqipëri mund t'i paraqesin Moskës mundësinë që ka pritur me shumë durim. Z. Enver Hoxha, 73 vjeç, raportohet të jetë në gjendje të keqe shëndetësore. Lajmi i radios shqiptare për "vetëvrastjen për shkak të depresionit nervor" të Mehmet Shehut, i dyti në komandë, sugjeron praninë e presioneve në rritje në Partinë Komuniste Shqiptare, ndërsa dita e lënies së trashëgimitarit afrohet. Ndjesia e një shansi të ri për Moskën padyshim që rritet nga izolimi i plotë i Shqipërisë. Amerika kapitaliste është armiku numër një i z. Hoxha, i ndjekur nga Bashkimi Sovjetik. Pas vdekjes së Mao Ce Dunit, Shqipëria futi Kinën, dikur aleatin e saj të vetëm, në një grup me Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimin Sovjetik. Jugosllavët dhe grekët, armiq tradicionalë të shqiptarëve, kanë ende projekte territoriale për Shqipërinë. Në procesin e ruajtjes së pastërtisë ideologjike marksiste të vendit të tij, zoti Hoxha e ka lënë atë fare pa miq ose aleatë.

Skenari sovjetik për veprim kundër Shqipërisë mund të jetë i parashikueshëm: një grusht shteti që pason operacionet e suksesshme në Çekoslovaki dhe Afganistan. Ndryshe nga situata në vitin 1961, Bashkimi Sovjetik sot ka forca të bollshme për ndërhyrje me rreze të gjatë dhe nuk jeton më me frikë nga Flota e

Gjashtë. Forcat ajrore mund të hidhen në Shqipëri, të kapin pistat kryesore të avionëve dhe të sjellin pajisje të rënda dhe forca të blinduara. Forcat amfibe nga skuadriljet e Detit të Zi dhe Mesdheut do të izoloni dhe mbështillinin Shqipërinë. Rezistenca nga ushtria dhe policia prej 50 mijë njerëzish e Shqipërisë, do të shtypej shpejt.


Shqipëria mund të bëhet baza më e rëndësishme pararojë e Bashkimit Sovjetik, aq e rëndësishme për ambicien e saj shekullore për të kontrolluar Mesdheun dhe Lindjen e Mesme, ashtu siç është Hauai për dominimin e Paqësorit nga Shtetet e Bashkuara. Pasojat politike të pranisë së Ushtrisë së Kuqe 50 milje nga Italia dhe disa qindra milje në veri të Athinës mund të imagjinojnë kollaj.

Por, imagjinata duket se mungon në Uashington. Mungesa e marrëdhënieve diplomatike me Shqipërinë që nga Lufta e Dytë Botërore e ka çuar Perëndimin në një lloj amnezie për ekzistencën e saj, dhe dikush pyet veten nëse ka ndonjë plan rezervë për t'u përballur me një krizë atje.

As Shtetet e Bashkuara dhe as Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut nuk kanë mbështetur zyrtarisht pavarësinë e vazhdueshme të Shqipërisë, duke e lënë Moskën me synimin joshës të një çmimi të vlefshëm strategjik, që mund të kapet pa rrezikun e një reagimi efektiv Perëndimor. Nëse një regjiment ajror Sovjetik do të ulej në aeroportin e Tiranës, përgjigja e mundshme e Uashingtonit do të ishte, "Ku është Tirana?"

Nëse Perëndimi nuk krijon një kordon mbrojtës diplomatik për Shqipërinë, duket e mundshme që ajo përsëri të bjerë nën Bashkimin Sovjetik - një ngjarje që mund të paralajmërojë zhvendosjen më drastike në ekuilibrin e fuqisë Evropiane, që nga Lufta e Dytë Botërore. /Burimi: NYT/Në shqip nga: Bota.al/





CARMEN BOULLOSA BISEDË ME ROBERTO BOLAÑO

# TË SHKRUASH DO TË THOTË TË ZHYTESH NË NJË ZONË LUFTE

**Carmen Boulosa:** Në Amerikën Latine ekzistojnë dy tradita letrare që lexuesi mesatar tenton t'i konsiderojë si përballë njëra-tjetrës, të kundërta ose, thënë ndryshe, antagonistë: ajo fantastike, në krye me Adolfo Bioy Casaresin dhe mjeshtrin Cortázar, dhe ajo realiste me Vargas Llosan, Teresa de la Parra. Tradita e shenjtë na dëfton se pjesa jugore e Amerikës Latine është shtëpia e fantastikës, ndërsa pjesa veriore është qendra e realizmit. Sipas mendimit tim, ju rrokni gjëra nga të dyja: romanet dhe tregimet tuaja janë krijime fantastike dhe një reflektim i mprehtë, kritik i realitetit të sotëm. Dhe nëse vazhdojmë këtë logjikë, do të shtoja se kjo ndodh për shkak se ju keni jetuar në dy skajet gjeografike të Amerikës Latine, Kilit dhe Meksikës. Pra, u rritët në të dyja skajet. Jeni kundër kësaj ideje, apo ju tërheq? Të them të drejtën, e shoh disi shndritëse por, gjithashtu, më lë të pakënaqur: shkrimtarët më të mirë, më të mëdhenjtë (përfshirë Bioy Casaresin dhe antitezën e tij, Vargas Llosan) gjithmonë marrin nga këto dy tradita. Megjithatë, nga këndvështrimi i veriut anglishtfolës ekziston një tendencë për ta mbërthyer letërsinë amerikano-latine brenda një tradite të vetme.

**Roberto Bolaño:** Mendova se realistët vinin nga jugu (me këtë

dua të them vendet në Konin Jugor), dhe shkrimtarët e fantastikës vinin nga pjesët e mesme dhe veriore të Amerikës Latine - nëse u kushtoni vëmendje këtyre ndarjeve, të cilat kurrë nuk duhet, në çdo rrethanë, të merren seriozisht. Letërsia e Amerikës Latine e shekullit 20 ka ndjekur impulset e imitimit dhe refuzimit dhe mund të vazhdojë ta bëjë këtë edhe për pak kohë në shekullin 21. Si rregull i përgjithshëm, qeniet njerëzore ose imitojnë ose refuzojnë monumentet e mëdha, kurrë thesaret e vogla, gati të padukshme. Kemi shumë pak shkrimtarë që kanë kultivuar fantastikën në kuptimin e ngushtë - mbase asnjë, sepse midis arsyeve të tjera, moszhvillimi ekonomik nuk lejon që të lulëzojnë nënzharet. Vazhdimi i zhvillimit lejon vetëm vepra të mëdha të letërsisë. Veprat më të vogla, në këtë peizazh monoton ose apokaliptik, janë një luks i paarritshëm. Sigurisht, kjo nuk tregon që letërsia jonë është plot me vepra të mrekullueshme, përkundrazi. Në fillim shkrimtari aspiron t'i përmbushë këto pritshmëri, por më pas realiteti, i njëjti realitet që ia ka nxitur këto aspirata, punon për ta penguar prodhimin përfundimtar. Unë mendoj se ka vetëm dy vende me

një traditë autentike letrare që disa herë kanë arritur t'i shpëtojnë këtij fati: Argjentina dhe Meksika. Sa i përket stilit tim, nuk di çfarë të them. Supozoj se është realist. Unë do të doja të isha një shkrimtar i fantastikës si Philip K. Dick, edhe pse me kalimin e kohës dhe plakjes, Dick më duket gjithnjë e më realist. Thellë-thellë, mendoj se do të pajtohesha me mua - pyetja nuk qëndron në dallimin mes realizmit dhe fantastikës, por në gjuhë dhe struktura, në mënyrat e të parit. Nuk e kisha idenë që ju pëlqente aq shumë Tereza de la Parra. Kur isha në Venezuelë njerëzit flisnin shumë për të. Unë kurrë nuk kam lexuar gjë prej saj.

**Carmen Boulosa:** Teresa de la Parra është një nga gratë shkrimtare, ose shkrimtarët më të mëdha dhe, kur ta lexoni, do të pajtoheni. Përgjigjja juaj mbështet plotësisht idenë se rryma që kalon nëpër botën letrare të Amerikës Latine është mjaft e rastësishme. Nuk do të thosha se është e dobët, sepse papritmas jep shkëndija që ndezin nga një skaj i kontinentit në tjetrin, por vetëm herë pas here. Ama pajtohem plotësisht për atë që unë e konsideroj si rregull. Natyrisht të gjitha ndarjet janë arbitrare. Kur mendova për jugun (Konin Jugor dhe Argjentinën),

mendova për Cortázarin, historitë delirante të Silvina Ocampos, Bioy Casaresit dhe Borgesit (kur flasim për autorë si këta, renditja nuk ka rëndësi: nuk ka "numri një"). Të gjithë ata janë autorë po aq të rëndësishëm), mendova për romanin e shkurtër e të paqartë të María Luisa Bombal, *Shtëpia e mjegullës* (fama e së cilës ishte, ndoshta, më shumë rezultat i skandalit - ajo vrau ishë dashurin e saj). Unë do të vija Vargas Llosan dhe të madhen De la Parra në kampin verior. Por atëherë gjërat bëhen të komplikuar, sepse teksta lëvizim edhe më në veri gjejmë Juan Rulfo dhe Elena Garro me *Un hogar sólido*<sup>1</sup> dhe *Los recuerdos del porvenir*<sup>2</sup>. Të gjitha ndarjet janë arbitrare: nuk ka realizëm pa fantazi dhe anasjelltas.

Në tregimet dhe romanet, ndoshta edhe në poezitë tuaja, lexuesi mund të gjejë "zgjidhje përfundimesh" (si homazhe të kryera), të cilat janë blloqe të rëndësishme për ndërtimin e strukturës suaj narrative. Nuk po them që romanet tuaja janë të shkruara me kode, por çelësi i kimitë suaj narrative mund të qëndrojë në mënyrën e përzjerjes së urrejtjes dhe dashurisë në ngjarjet që ju rrëfeni. Si bën punën Roberto Bolaño, mjeshtri kimist?

**Roberto Bolaño:** Nuk besoj se ka më shumë "zgjidhje përfundimesh" në krijimet e mia sesa në krijime të ndonjë autori tjetër. Këmbëngul në rrezikun se kjo tingëllon si pedante (gjë së cilës unë i përkas, në çdo farë rasti), që kur shkruaj e vetmja gjë që më intereson është vetë shkrimi; domethënë forma, ritmi, komploti. Qesh me disa qëndrime, me disa njerëz, me agenda të caktuara dhe çështje me rëndësi, thjesht sepse kur përballesh me marrëzira të tilla, me ego tilla të fryra, nuk ke tjetër zgjidhje përveçse të qeshësh. E gjithë letërsia, në një kuptim të caktuar, është politike. Dua të them, fillimisht, është njëfarë reflektimi mbi politikën dhe, së dyti, është një program politik. I pari aludon në realitet, në makthin ose ëndrën dashamirëse që ne e quajmë realitet, e cila përfundon, në të dy rastet, me vdekjen dhe shfarosjen jo vetëm të letërsisë, por edhe të kohës. E dyta iu referohet copëzave të vogla që mbijetojnë, që vazhdojnë të arsyetojnë. Megjithëse e dimë, natyrisht që në nivelin njerëzor të gjërave, këmbëngulja është iluzion dhe arsyeja është vetëm dërrasë e dobët që na mban nga zhytja në humnerë. Por mos ia vini veshin kësaj që sapo thashë. Supozoj se dikush shkruan nga ndjeshmëria, kjo është e gjitha. Dhe pse shkruan?

Më mirë të mos më thuash, jam i sigurt që përgjigja juaj do të jetë më e rrjedhshme dhe bindëse se e imja.

**Carmen Boulosa:** Në rregull, s'do ta tregoj sepse përgjigja ime do të ishte më bindëse, por më duhet të them që nëse ka ndonjë arsye pse s'shkrual, është nga ndjeshmëria. Për mua, të shkruash do të thotë të zhytesh në një zonë luftime, të çash barkun, të luftosh me eshtrat e kufomave, pastaj të përpiqesh të mbash të paprekur zonën e luftimeve, ende i gjallë. Dhe ajo që ju e quani "zgjidhje përfundimesh" më duket shumë më e ashpër në punën tuaj sesa në punën e shumë shkrimtarëve të tjerë të Amerikës Latine.

Në sytë e këtij lexuesi humori juaj është shumë më tepër sesa një gjest; është shumë më gërryes, është një lloj prishjeje. Në librat tuaj aspektet e brendshme të romanit vazhdojnë në mënyrën klasike: një fabul, një trillim tërheq lexuesin dhe në të njëjtën kohë e bën atë një bashkëpunëtor për ndarjen e ngjarjeve, në sfondin që ju, romancier, po rrëfeni me besnikëri ekstreme. Por për momentin le ta lëmë këtë. Askush që ju ka lexuar nuk mund të dyshojë mbi besnikërinë tuaj në të shkruar. Kjo është gjëja e parë që tërheq lexuesin. Kushdo që dëshiron të gjejë diçka tjetër përveç shkrimit në një libër, për shembull, një ndjenjë përkatësie, ose të qenit anëtar i një grupi apo shoqërie të caktuar, nuk do të gjejë asnjë kënaqësi në romanet ose tregimet tuaja. Dhe kur ju lexoj, nuk kërkoj historinë, ritregimin e një periudhe pak a shumë të kohëve të fundit në ndonjë qoshe të botës. Pak shkrimtarë e angazhojnë lexuesin ashtu siç bëni ju, me skena konkrete që mund të jenë inerte, pasazhe statike në duart e autorëve "realistë". Nëse i përkisni një tradite, si mund ta quanim? Ku janë rrënjët e pemës suaj gjenealogjike dhe në cilin kah zgjaten degët e saj?


**Roberto Bolaño:** E vërteta është se unë nuk besoj aq shumë te të shkruarit. Duke nisur që nga vetja. Të jesh shkrimtar është e këndshme. Jo, e këndshme, s'është fjala e duhur. (Të shkruarit).<sup>3</sup> Është një aktivitet që ka çastet e veta zbatimëse, por unë di për gjëra të tjera që janë edhe më zbatimëse, zbatimëse në të njëjtën mënyrë siç është për mua letërsia. Të jesh hajdut banke, për shembull. Ose regjisor filmash. Ose të jesh zhigolo. Ose të jesh përsëri fëmijë dhe të luash në një ekip futboll. Për fat të keq, fëmija rritet, grabitësi i bankës vritet, drejtori mbaron paratë, zhigoloja sëmuret dhe atëherë nuk ka zgjidhje tjetër përveçse të shkruash. Për mua fjala shkrim (writing) është krejt e kundërta e fjalës pritje (waiting). Në vend të pritjes, ka shkrim. Në rregull, ka gjasë ta kem gabim, mundet që shkrimi të jetë një formë tjetër pritjeje e vonimit të gjërave. Do të doja të mendoja ndryshe. Por, siç e thashë, ndoshta e kam gabim. Sa i përket idesë sime për një normë, nuk e di, si të gjithë, jam në siklet ta

them, është kaq e dukshme: Francisco de Aldana, Jorge Manrique, Cervantes, kronikanët e Indive, Sor Juana Inés de la Cruz, Fray Servando Teresa de Mier, Pedro Henríquez Ureña, Rubén Darío, Alfonso Reyes, Borges, për të përmendur vetëm disa dhe pa kaluar përtej gjuhës spanjolle. Sigurisht, do të doja tapretendoja një të kaluar letrare, një traditë, një krejt të shkurtër, të përbërë nga vetëm dy ose tre shkrimtarë (dhe ndoshta një libër i vetëm), një traditë verbuese e prire për amnezi por, nga njëra anë, jam shumë modest për punën time dhe, nga ana tjetër, kam lexuar shumë (dhe shumë libra më kanë bërë të lumtur) për t'u mjaftuar me një nocion kaq qesharak.

**Carmen Boulosa:** A nuk tingëllon arbitrare të përmendni si paraardhësit tuaj letrarë autorë që shkruan vetëm në spanjisht? A e përfshini veten në traditën hispanike, në një rrymë të veçantë nga gjuhët e tjera? Nëse një pjesë e madhe e letërsisë amerikano-latine (veçanërisht proza) është e përfshirë në një dialog me traditën e tjera, unë do të thosha se kjo është dyfish e vërtetë në rastin tuaj.

**Roberto Bolaño:** Përmenda autorë që shkruanin në spanjisht për ta kufizuar normën. Është e panevojshme të thuhet, nuk jam nga ata përbindësia nacionalistë që lexojnë vetëm ato që dalin nga vendi i tij i lindjes. Jam i interesuar për letërsinë franceze, për Pascalin, i cili mund ta parashikonte vdekjen e tij dhe për luftën e tij kundër melankolisë, e cila për mua duket më e admirueshme se kurrë më parë. Ose për naivitetin utopik të Fourierit. Dhe gjithë prozën, tipike anonime, të shkrimtarëve elegantë (disa manieristë dhe disa të tjerë anatomistë) që çojnë disi në shpellat e pafundme të Markezit de Sade. Gjithashtu, jam i interesuar për letërsinë amerikane të viteve 1880, veçanërisht Twainin dhe Melvillein, dhe për poezinë e Emily Dickinsonit dhe të Whitmanit. Si adoleshent kalova një fazë kur lexova vetëm Poen. Në thell, kam interes për letërsinë perëndimore dhe jam mjaft i njohur me të gjitha.

**Carmen Boulosa:** Ju lexoni Poen? Mendoj se ekzistonte një virus Poe shumë ngjitës në brezin tonë. Ai ishte idhulli ynë dhe unë fare lehtë mund t'ju shoh si një adoleshent i infektuar. Por po ju imagjinoj si një poet dhe dua t'u kthehem rrëfimeve tuaja. A e zgjidhni komplotin, apo komploti ju ndjek? Si e zgjidhni ju, ose si ju zgjedh komploti? Dhe nëse nuk është asnjëra, atëherë çfarë ndodh? Këshilltari i Pinochetit për marksizmin, kritikja letrare shumë e respektuar kiliane që e pagëzoni Sebastián Urrutia Lacroix, një prift dhe anëtar i Opus Dei<sup>4</sup>, ose shërues që praktikon mesmerizmin<sup>5</sup>, ose poetët adoleshentë të njohur si Dedektivët e Egër, të gjithë këta personazhe tuajat kanë një ngjashmëri historike. Pse ndodh kjo?



**Roberto Bolaño:** Po, komplotet janë një çështje e çuditshme. Besoj, edhe pse mund të ketë shumë përjashtime, që në një çast të caktuar një histori të zgjedhë dhe nuk do me të lënë në paqe. Për fat të mirë, kjo nuk është aq e rëndësishme. Forma, struktura, gjithmonë na përkasin neve dhe pa formë ose strukturë nuk ka asnjë libër ose, të paktën, në shumicën e rasteve kështu ndodh. Le të themi që historia dhe komploti lindin rastësisht, se ato i përkasin sferës së fatit, domethënë kaosit, çrregullit ose një fushe që është në trazira të vazhdueshme (disa e quajnë apokaliptike). Nga ana tjetër, forma është një zgjedhje e bërë përmes inteligjencës, dinakërisë dhe heshtjes, të gjitha armët e përdorura nga Uliksi në betejën e tij kundër vdekjes. Forma kërkon një artificë; historia kërkon një greminë. Ose të përdorë një frazeologji nga fshati kilian (një të keqe, siç do ta shihni): Nuk është se nuk më pëlqejnë greminat, por preferoj t'i shoh nga një urë.

**Carmen Boulosa:** Gratë shkrimtare bezdisen vazhdimisht nga kjo pyetje, por nuk mund të mos e shkaktoj edhe te ju, nëse do të jeni pyetur shumë herë. E konsideroj si një ritual të pashmangshëm, megjithëse të pakëndshëm: Sa material autobiografik ka në punët tuaja? Deri në çfarë mase janë autoportretet?

**Roberto Bolaño:** Autoportret? Jo shumë. Një autoportret kërkon një lloj të caktuar egoje, një gatishmëri për ta parë veten pa pushim, një interes të dukshëm për atë që je ose ke qenë. Letërsia është plot me autobiografi, disa shumë të mira, por autoportretet kanë tendencë të jenë shumë të këqija, duke përfshirë autoportretet në poezi, të cilat në fillim duken se ishin një zhanër më i përshtatshëm për autoportretin sesa proza. A është puna ime autobiografike? Në njëfarë kuptimi, si mund të mos ishte? Çdo farë vepe, përfshirë epikën, është në njëfarë mënyre autobiografike. Në *Iliadë* ne konsiderojmë fatin e dy aleancave, të një qyteti, të dy ushtrive, por ne gjithashtu e konsiderojmë fatin e Akilit, të Priamit dhe të Hektorit, dhe të gjithë këta personazhe, këta

zëra individualë, pasqyrojnë zërin, vetminë e autorit.

**Carmen Boulosa:** Kur ishim poetë të rinj, adoleshentë dhe ndanim të njëjtin qytet (qyteti i Meksikës në vitet '70), ju ishit udhëheqës i grupit të poetëve *Infrarealistët*, të cilin e keni mitizuar në romanin tuaj, *Detektivët e egër*. Na tregoni pak se çfarë domethënie kishte poezia për infrarealistët, për qytetin e Meksikës së infrarealistëve.

**Roberto Bolaño:** Infrarealizmi ishte një lloj dadaizmi alla meksikançe. Në një çast kishte shumë njerëz, jo vetëm poetë, por edhe piktorë dhe sidomos *llokumet* dhe *varëset*, të cilët e konsideronin veten infrarealistë. Në të vërtetë ishim vetëm dy pjesëtarë, Mario Santiago dhe unë. Ne të dy shkuam në Evropë më 1977. Një natë, në Rosellón të Francës, në stacionin e trenit Port Vendres (i cili është shumë afër Perpignanit), pasi kaluam disa aventura katastrofike, vendosëm që lëvizjes, siç qe, i kishte ardhur tashmë fundi.

**Carmen Boulosa:** Ndoshta mbaroi për ju, por mbeti gjallë në kujtimet tona. Të dy ishit tmerret e botës letrare. Atëherë unë isha pjesë e një turme solemne, serioze, bota ime ishte aq e shkëputur dhe pa formë, sa që më duhej diçka e sigurt për ta mbajtur. Më pëlqente natyra ceremoniale e leximeve dhe pritjeve poetike, ato ngjarje absurde dingas me rituale, të cilat pak a shumë i mbaja, dhe ti ishe përçarës i këtyre tubimeve. Para leximit tim të parë me poezi në librarinë "Gandhi", më 1974, unë iu luta Zotit, jo se vërtet besoja në Zot, por kisha nevojë për dikë që të thirrja dhe iu luta: Të lutem, mos i lejo infrarealistët të vijnë. Isha e tmerruar të lexoja në publik, por ankthi që lindi nga ndrojtja ime nuk ishte asgjë në krahasim me panikun që ndieja rreth mendimit se do të tallesha: në gjysmën e leximit, infrasit mund të shpërthenin dhe të më quanin idiote. Ju ishit atje për ta bindur botën letrare që nuk duhet ta merrnin veten aq seriozisht për punët që nuk ishin legjitimisht serioze - dhe se me poezi (për ta kundërshtuar thënien tuaj kiliane) pika e saktë ishte të hidhesh nga gremina. Por më lejoni të kthehem te Bolaño dhe puna e tij. Ju jeni mjeshër në rrëfime. Unë nuk mund ta imagjinoj askënd tek i

quan romanet tuaja "lirike" por, megjithatë, ju jeni gjithashtu një poet, një poet aktiv. Si i pajtoni këta të dy?

**Roberto Bolaño:** Nicanor Parra thotë se romanet më të mira janë shkruar në metrikë, ndërsa Harold Bloom thotë se poezia më e mirë e shekullit 20 është shkruar në prozë. Pajtohem me të dy. Por, nga ana tjetër, e kam të vështirë ta konsideroj veten një poet aktiv. Kuptimi im për një poet aktiv është ai që shkruan poezi. Unë ju dërgova ato më të fundit dhe kam frikë se janë të tmerrshme, megjithëse natyrisht, nga mirësia dhe konsiderata, ju nuk do ta thoni të vërtetën. S'e di. Ka diçka në lidhje me poezinë. Sido që të jetë rasti, e rëndësishme është të vazhdohet të lexohet. Kjo është më e rëndësishme se të shkruash. Nuk mendon kështu? E vërteta është se leximi është gjithmonë më i rëndësishëm sesa shkrimi.

## Shënime për të intervistuarin dhe intervistuesen

Roberto Bolaño (prill 1953-15 korrik 2003) ishte romancier kilian, regjitar, poet dhe eseist. Më 1999 fitoi Çmimin "Rómulo Gallegos" për romanin *Detektivët e egër* (përkthyer në shqip nga Bajram Karabollli) dhe më 2008, pas vdekjes, iu dha Çmimi Kombëtar i Kritikëve të Librit për romanin *2666* (përkthyer në shqip nga Bashkim Shehu). *New York Times* e përshkroi atë si *zëri letrar më domethënës i Amerikës Latine të brezit të tij*.

Carmen Boulosa është autore e romaneve dhe novelave, e poezive, e shfaqjeve dhe disa përshtatjeve teatrore, tregimeve të shkurtura dhe eseve kritike. Librat e saj janë përkthyer në frëngjisht, gjermanisht, holandisht dhe italisht. Ajo ka marrë çmimin letrar meksikan "Xavier Villaurrutia" (1989), një bursë Guggenheim (1992) dhe një grant DAAD (1995). Ajo është anëtare e Qendrës për Studiuesit dhe Shkrimtarët e Bibliotekës Publike të Nju-Jorkut.

*Kjo intervistë është publikuar në antologjinë 'Bomb Magazine'.*

*(Marrë nga numri i 11-të i revistës "Akademia")*

<sup>1</sup> "Një shtëpi e fortë": Roman i shkrimtares dhe gazetares meksikane Elena Garro (gruaja e Oktavio Pazit)

<sup>2</sup> "Kujtimet e së ardhmes": Roman i Elena Garros

<sup>3</sup> Shtesë e përktheysit

<sup>4</sup> Organizatë katolike e laikëve dhe priftërinjëve e themeluar në Spanjë në 1928 me synimin për të rivendosur idealin e krishterë në shoqëri.

<sup>5</sup> Magnetizmi i kafshëve, i njohur gjithashtu si hipnotizim, ishte emri i dhënë nga mjeku gjerman Franz Mesmer në shekullin e 18-të asaj që ai besonte të ishte një forcë e padukshme natyrore e zotëruar nga të gjitha gjallesat, duke përfshirë njerëzit, kafshët dhe perimet.

**EURO GLASS**  
 SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
 Envert  
 Adr: Fushë Kosovë  
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
 E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE  
 'BUJQËSIA'  
 TEL: 045/82 82 82**

# Januzi dhe Carioca te Dukagjini, mungon vetëm zyrtarizimi

KF Dukagjini në parim ka arritur marrëveshje me sulmuesin Ahmed Januzi dhe mesfushorin Jean Carioca, kurse kanë mbetur vetëm disa hollësi për zyrtarizimin e marrëveshjes. Drejtori sportiv i Dukagjinit, Fabian Veseli, ka lënë të nënkuptohet se këta dy futbollistë mund ta dërsitin fanellën e Dukagjinit

**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 13 KORRIK - Skuadra e Dukagjinit nga Klina u tregua skuadër fantastike në edicionin 2020/21 pasi arriti deri në finale të Kupës së Kosovës dhe u inkuadrua në Superligën e Kosovës. Skuadra e vetme që është pjesë e elitës nga Rrafshi i Dukagjinit pritet të jetë një skuadër e fortë në sezonin e ri. Drejtuesit e klubit fillimisht kishin arritur marrëveshje për vazhdimin e bashkëpunimit me shtabin teknik, trajnerin Armend Dallku dhe ndihmësit e tij Artan Luzi dhe Agon Ramadan, kurse tash po punojnë për përfundime. Gazeta "Epoka e re" ka mësuar se kjo skuadër ka arritur marrëveshje me sulmuesin Ahmed Januzi dhe mesfushorin Jean Carioca, por drejtori sportiv i kësaj skuadre, Fabian Veseli, ka thënë se janë në bisedime, por ende nuk ka marrëveshje. "Ende nuk kemi arritur marrëveshje, por jemi në bisedime të avancuara. Shumë shpejt do të merret vendimi përfundimtar", ka thënë Veseli. "Krejt çka mund të them tash për tash është se në kampionatin e ri do të jemi skuadër serioze në Superligë. Në ditët e ardhshme do të sjellim edhe përfundime për ato pozita ku shtabi teknik i shihet të domosdoshme", ka shtuar ai. Ish-reprezentuesi i Kombëtares së Shqipërisë, Ahmed Januzi, i cili në edicionin e fundit ishte pjesë e skuadrës së Llapit, pritet të jetë



zëvendësues i sulmuesit veteran Labinot Osmani, i cili vendosi të largohet nga Dukagjini dhe të rikthehet në skuadrën e Vushtrrisë në Ligën e Parë. Ndërsa mesfushori brazilian Jean Carioca, i cili për një kohë të gjatë ishte pjesë e Feronikelit, vendosi të mos

mbetet pjesë e skuadrës nga Drenasi, pasi kjo e fundit është në krizë dhe shumica e futbollistëve kryesorë janë larguar. Ndeshjen e parë në Superligë në edicionin e ri, Dukagjini e zhvillon në Suharekë ndaj Ballkanit më 21 gusht.

## SHKURT

### Ballkani përgatitet në Mavrovë

Skuadra e Ballkanit ka nisur të martën edhe zyrtarisht përgatitjet për edicionin e ri 2021/22. Skuadra nga Suhareka, që është ndër më të dalluarat në vitet e fundit në futbollin e Kosovës, përgatitjet po i kryen në Mavrovë. "Skuadra ka nisur zyrtarisht përgatitjet në Mavrovë, aty ku edhe ka zhvilluar stërvitjen e parë. Atmosfera në skuadër është shumë e mirë dhe ngarkesa që stafi teknik i ka dhënë ekipit, po bën që futbollistët ta arrijnë formën fizike", thuhet në njoftimin e skuadrës së Ballkanit.

### Malishevës i largohet kapiteni pas 14 vjetësh

Skuadra e inkuadruar në Superligën e Kosovës, Ulpiana, do të mbetet pa njërin nga futbollistët më besnik të klubit. Ishte vetë kapiteni i skuadrës që nëpërmjet një postimi në rrjetet sociale ka njoftuar për ndarjen e tij me Malishevën pas 14 vjetësh. "Pas 14 vjetësh kapiteni i Klubit të Futbollit Malisheva ju njoftoj që nuk jam më pjesë e tij. Malishevës i uroj fat në Superligë! Jam krenar me atë që kemi arritur si klub që nga fillimet e para e deri tek inkuadrimi në Superligë. Pavarësisht prej rrethanave, Malisheva mbetet klubi i zemrës", ka shkruar Sertolli.

### Jorginho: Topi i Artë? Nuk konkurrohet ndaj Messit, Ronaldos dhe Neymarit

Mesfushori i Italisë, Jorginho, po konsiderohet kandidat serioz për fitimin e "Topit të Artë" pas trofeve të fituar me kombëtaren dhe klubin. Jorginho ishte duke folur në një intervistë për "SportTv" kur u pyet për mundësinë e fitimit të çmimit individual më prestigjioz në botën e futbollit. "Jetojmë të ëndërrime, por të jem i sigurtë mendoj që varet nga kriteret që i kanë dhe pritshmëritë e tyre. Sa i përket talentit, jam i vetëdijshëm që nuk jam më i miri në botë. Nëse flasim për titujt e fituar, askush s'ka fituar titujt më shumë se unë këtë sezon", ka thënë Jorginho. "Si të konkurroj me Messin, Ronaldon dhe Neymarin? Ata kanë karakteristika plotësisht të ndryshme nga unë por, e përsëris, varet nga kriteret", ka shtuar Jorginho.

## Bytyqi: Shpresojmë ta përfaqësojmë sa mirë Kosovën

PRISHTINË, 13 KORRIK - Kosova A për herë të parë do të garojë zyrtarisht në arenën ndërkombëtare. Vashat dardane do të garojnë në Kampionatin Evropian për Shtete të Vogla, nga 20 deri më 25 korrik në Qipro. Basketbollistja me përvojë, Valbona Bytyqi, thotë se janë shumë të motivuara. "Përgatitjet po shkojnë shumë mirë. Ka qenë një frymë pozitive deri më tani. Lojtarët janë të

motivuar dhe po e presim me padurim fillimin e ndeshjeve dhe të përfaqësojmë sa më mirë shtetin e Kosovës", është shprehur Bytyqi për faqen zyrtare të FBK-së. Synimet e Kosovës janë të qarta. "Synimet tona janë që sa më mirë ta përfaqësojmë Kosovën në arenën ndërkombëtare dhe ta bëjmë krenar shtetin e Kosovës", shton tutje basketbollistja e Penzës.

Kosova është në grup me Qipron dhe Luksemburgun. "Është hera që po e përfaqësoj Kosovën ndërkombëtare dhe do të bëj të pamundurën që ta përfaqësoj Kosovën sa më mirë. Dua që edhe vajza ime të jetë krenare me mua", nënvizon Valbona Bytyqi. Kujtojmë se kjo është hera e parë që Kosova A te femrat garon në arenën ndërkombëtare.



## Donnarumma: Nuk kam festuar menjëherë sepse mendova se ishin duke humbur

Londër, 13 korrik - Pasi triumfuan në finalen e madhe të "Euro 2020" duke u shpallur kampionë të Evropës pas 53 vjetësh, Gianluigi Donnarumma ka shpjeguar për "SKY Sport 24" arsyen përse nuk festoi menjëherë

pas pritjes së penaltisë ndaj Sakasë, duke thënë se nuk e kishte kuptuar ende sepse pas penaltisë së humbur nga Jorginho kuptova se ishin duke humbur. "Dua ende të realizoj gjithçka. Forca ime ka qenë e njëjta. Nuk kam

festuar menjëherë sepse nuk kisha kuptuar asgjë. Pasi humbi penalltinë Jorginho, mendova se ishim duke humbur, por më pas kam hedhur sytë te gjyqtari për të kuptuar nëse gjithçka ishte në rregull. Më pas kam parë

shokët e skuadrës të vinin drejt meje dhe më pas nuk kam kuptuar asgjë...", ka shpjeguar Donnarumma reagimin e tij pas 11-metërshit të pritur ku i dha trofeun Italisë pas 53 vjetësh pritje.



## Shoshaj: Krenar që luaj për Kosovën

PRISHTINË, 13 KORRIK - Kosova U20 (meshkujt) po vazhdon përgatitjet intensive për garat ndërkombëtare. Në ekipin e Kosovës U20 ka disa basketbollistë që luajnë në Kosovë, por edhe disa që luajnë në ligat evropiane. Fatlind Shoshaj është grumbulluar për herë të parë me Kosovën U20. Ai është pjesë e klubit Kangoeroes Basket Mechelen në Belgjikë. "Përgatitjet po shkojnë shumë mirë. Nuk e kam pritur që do të shkojnë kaq mirë. Trajneri (Mark Rodiqi) është shumë i mirë dhe po na jep shumë këshilla të mira në stërvitje", ka thënë Shoshaj për faqen zyrtare të FBK-së. Ai flet edhe për rëndësinë që ka për të luajtur për Kosovën. "Është kënaqësi të jem pjesë e Kombëtares së Kosovës dhe shpresoj në rezultate pozitive në turneun në Hungari. Kjo është hera e parë që jam pjesë e Kosovës



dhe shpresoj se do të jem edhe në të ardhmen. Më kanë pritur shumë mirë lojtarët dhe stafi. Për këtë i falënderoj shumë", ka shtuar Shoshaj.

Kosova U20 (M) do të marrë pjesë në Grupin E të FIBA U20 European Challengers që do të mbahet prej 20 deri më 25 korrik

2021 në Sopron të Hungarisë. "Ne udhëtojmë vetëm për fitore. Nuk e di nëse do të shënojmë vetëm fitore, por ky është qëllimi që shkojmë në Hungari", ka deklaruar Shoshaj.

Kosova është në grup me Bjellorusinë, Hungarinë e Sllovakinë.

## UEFA zbulon formacionin më të mirë për 'Euro 2020', harron Ronaldo

LONDËR, 13 KORRIK - UEFA ka shpallur formacionin më të mirë të Euro 2020. Pjesa më e madhe e tyre janë nga skuadrat gjysmëfinaliste dhe finaliste. Italia fituese përfaqësohet me plot pesë lojtarë, duke qenë edhe skuadra me më shumë lojtarë në formacion. Në vendin e dytë është Anglia finaliste, e cila përfaqësohet me tre lojtarë. Në rreshtim kanë merituar nga një vend edhe Pedri i Spanjës, Højbjerg i Danimarkës dhe Lukaku i Belgjikës. Ajo që bie më shumë se gjithçka në sy është mungesa e Ronaldos. Portugezi u eliminua që në raundin e 1/8-ve me Portugalinë e tij nga Belgjika, por vetëm katër ndeshje i mjaftuan kapitenit luzitan të shënonte 5 gola e të dhuronte 1 asist dhe të shpallej golashënuesi më i mirë i turneut. Specialistët në vend të tij kanë zgjedhur Lukakun. Pjesëtarët e komisionit përzgjedhës të formacionit janë: Packie Bonner, Esteban Cambiasso, Fabio Capello, Cosmin Contra, Corinne Diacre,



Jean-François Domergue, Dusan Fitzel, Steffen Freund, Frans Hoek, Aitor Karanka, Robbie Keane, Ginés Meléndez, David Moyes, Mixu Paatelainen, Peter Rudbæk dhe Willi Ruttensteiner.

### FORMACIONI

Portier: Gianluigi Donnarumma (Italy)  
Mbrojtës: Kyle Walker (Anglia), Leonardo Bonucci (Italia), Harry Maguire (Anglia), Leonardo Spinazzola (Italia)  
Mesfushorë: Pierre-Emile Højbjerg (Denmark), Jorginho (Italy), Pedri (Spain)  
Sulmues: Federico Chiesa (Italia), Romelu Lukaku (Belgjika), Raheem Sterling (Anglia)

### SHKURT

#### 'Dream Team' humbet miqësoren me Australinë

Kombëtarja amerikane e basketbollit, e famshme "Dream Team", ka harruar të fitojë. Pas humbjes turpëruese ndaj Nigerisë (90-87) në miqësoren e një dite më parë në Las Vegas (hera e parë që Amerika humbet ndaj një ekipi afrikan), ka mbërritur një tjetër disfatë. Këtë herë ekipi i trajnerit Gregg Popovich u mund 91-83 nga Australia, në takimin e radhës të luajtur në Las Vegas. Kjo është hera e parë që prej vitit 1992 që kombëtarja amerikane e basketbollit humbet dy ndeshje radhazi edhe pse bëhet fjalë për dy miqësore. Nga viti 1992 deri në korrik të këtij viti Amerika kishte humbur vetëm dy miqësore, ndërsa tani humbi dy të tilla në 48 orë. Këto miqësore janë pjesë e programit stërvitor që "Dream Team" po bën në prag të Lojërave Olimpikë "Tokio 2020".

#### Joao Mario kalon te Benfica

Joao Mario ka kaluar në një transferim të lirë në Benfica pasi përfundoi marrëveshjen me Interin. Benfica ka njoftuar nënshkrimin e 28-vjeçarit i cili kaloi mandatin e fundit në huazim të Sporting CP, raporton "Football Italia". Sporting shpresonte që mesfushori të kthehej në një marrëveshje të përhershme, por Benfica ka arritur të bëjë marrëveshje me agjentin e lirë.

#### De Paul përforcon Atleticon

Vetëm pak ditë pas rinovimit të kontratës, trajneri Diego Simeone merr një tjetër dhuratë nga drejtuesit e Atletico's së Madridit. Bëhet fjalë për mesfushorin argjentinas Rodrigo De Paul, që është prezantuar zyrtarisht si blerja më e re e "Los Colchoneros". Këta të fundit arritën pak ditë më parë marrëveshjen me Udinesen për shifrën e 35 milionë eurove, plus pesë të tjera në formë bonusi. Fantazisti argjentinas e nisi karrierën te Rasing dhe u transferua fillimisht te Valencia në 2014-n, por pa arritur të lërë gjurmë. Verën e 2016-s iu bashkua Udineses në Serinë A dhe nga sezoni në sezon, e rriti ndjeshëm nivelin e performancës në fushë, duke u bërë objekt dëshirash për shumë klube.

#### Locatelli: Më pëlqen Juventus

Manuel Locatelli është një nga lojtarët më të përfolur në merkato. Për mesfushorin e Sassuolos ka interes nga e gjithë Evropa, por edhe një herë ai lë të kuptohet se Juventus është destinacioni i tij i pëlqyer për të ardhmen. "Deri më tani nuk e kam menduar fare merkaton. Është kënaqësi që Juventus interesohet për mua. Është klub i shkëlqyer. E ka thënë disa herë këtë. Tani nisim të mendojmë për merkaton. Mund të them vetëm se më 7 gusht, kur motra ime martohet, do të kërkoj leje për të qenë atje, pavarësisht se në cilin ekip do të luaj", u shpreh Locatelli.

## Russelli: Jam në kontakt të vazhdueshëm me Mercedesin

Ka garuar vetëm një herë me Mercedesin, kur zëvendësoi Lewis Hamiltonin sezonin e kaluar (i infektuar me koronavirus) në Sakhir, por e ardhmja e pilotit të ri britanik

George Russell pritet të jetë sërish makina gjermane. Është vetë piloti i Williamsit ai që konfirmon se bisedimet me Mercedesin, ku pritet ta zëvendësojë sezonin e ardhshëm Valtteri Bottas. "Jam në

kontakt të vazhdueshëm me Mercedes, me Toto Wolff. Ata janë kujdesur gjithnjë për mua. Jam një pilot që vij nga shkolla e tyre, ndaj kanë kontrollin e fatit tim. Më kanë thënë gjithnjë se nëse

bëj një punë të mirë, do të shpërblehem", ka thënë Russell. Më tej, piloti britanik ka shtuar: "Jam një pilot i Mercedesit dhe i jam besnik kësaj marke. Gjithsesi, dua të duelloj për titullin dhe jo të

renditem në vendin e 15-të dhe këtë gjë dua ta bëj sa më herët të jetë e mundur. Po bëj më të mirën e mundshme nga java në javë, ndaj të shohim se si do të shkojnë gjërat".



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Trepça Shoqëri Aksionare  
Trepça Deoničarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



Duke u bazuar ne Rregulloren për dhënie me qira te pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokoll 119 date 11.01.2021, divizioni i shitjes dhe qirasë me datën 13.07.2021 bënë shpallje publike për dhënie e pronës së paluajtshme me qira.

### Shpallje Publike

#### T-21-005

Qëllimi i ofertës: Dhënie me qira e hapësirave – Metalurgjia e Zinkut  
Kriteret e Dhënies: Dhënia e kontratës do të bazohet Çmimi më i lartë  
Periudha: 3(tre) vite me mundësi vazhdimi  
Data e shpalljes: 13.07.2021  
Sqarimi: deri me 28.07.2021  
Kërkesa për pjesëmarrje: Data(t) për kërkesës deri: 29.07.2021  
Behet ne e-Mail: poshtë shënuar ose në zyrën e Divizioni i shitjes dhe qirasë.  
Siguria e ekzekutimit: Shuma e Sigurisë së Ekzekutimit 3 (tri) pagesa mujore nga vlera e përgjithshme e kontratës, për kohëzgjatjen e periudhës prej 3 vite nga data e nënshkrimit të kontratës.  
Dorëzimi i ofertave: Dorëzimi i ofertave bëhet ne formë fizike (zarf te mbyllur)  
Afati i fundit i dorëzimit: 30.07.2021 në 10:00  
Vendi i dorëzimit: Divizioni i shitjes dhe qirasë Trepça Sh.A.  
Parku Industrial, Mitrovicë

#### AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

Emri zyrtarë: <i>Trepça sh.a.</i>		
Adresa postare: <i>Parku industrial</i>		
Qyteti: <i>Mitrovicë</i>	Kodi postarë: <i>40000</i>	Shteti: <i>Kosovë</i>
Kontakti: <i>Burim HAJDINI</i>		Telefoni: <i>+383 (0) 28 538 050</i>
Email: <i>sales@trepçacorporation.com</i>		Faksi: <i>+383 (0) 28 539 202</i>
<i>www.trepçacorporation.com</i>		



REPUBLIKA E KOSOVËS-REBUBLIKA KOSOVA- REPUBLIC OF KOSOVA

### Ndërmarrja Publike Lokale "Stacioni i Autobusëve" Sh.A.

FERIZAJ

Kryeshefi Ekzekutiv i Stacioni Autobusëve Sh.a.Ferizaj në bazë të nenit 16 pika 1 të Statutit të kompanisë, Ligjit të Punës nr.03.L-212 neni 8 dhe 10 pika 2.2 Rregulloren mbi organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës dhe Organogramin, lidhur me plotësimin e vendit të punës, shpallë:

#### KONKURS

#### ME KOHË TË CAKTUAR I VJET ME MUNDËSI VAZHDIMI

Për vendin e punës.

(1) ASISTENT/E e ZYRTARIT TË LARTË FINANCIAR

(1) SPIKER/ E – BILETAR/E

(2) DISPIÇER

Kualifikimet e nevojshme:

Kërkesën dhe CV

- Shkolla e mesme
- Aftësi për të punuar në mënyrë pavarur dhe si pjesë e ekipit
- Shkathësi të shkëlqyeshëm komunikues
- Shkathësi të shkëlqyeshëm për kompjuter (Certifikatën nga ndonji institucion kredibil).
- Përovja e punës është e dëshirueshme
- Dëshmi se nuk është nën hetime

Vlerësimi dhe intervista do të bëhen pas përfundimit të afatit për aplikim  
Lartësia e pagës përcaktohet në harmoni me politikat e Kompanisë  
Kandidatët e interesuar mund të marrin aplikacionin në zyrën e kompanisë N.P.L Stacioni i Autobusëve SH.A në Ferizaj dhe po në të njëjtin vend edhe mund të dorëzojnë aplikacionet. Dokumentacioni i pa kompletuar nuk do të konsiderohet të vlefshëm. Në intervistë do të ftohen vetëm kandidatët të cilët do të hyjnë në listën e ngushtë, pas seleksionimit të dokumentacionit të paraqitur nga komisioni përkatës.

Afati për dorëzimin e aplikacionit është 8 ditë nga dita e publikimit të konkursit prej orës 8:00 - 16 :00.

Ferizaj, 13.07.2021



### Thirrja për aplikim (DHËNJE TË OFERTËS)

**"BIOFARM ISTOG" SH.P.K.- Nr. Unik.biznesit: 811224964**

me seli Rr. **Fshati Dubravë p.n.Istog -Kosovë** me pronare/ **RAHIME ARIFAJ**, bënë këtë SHPALLJE Fetesë për Koutim ( Dhënie te Ofertes) për kompanit e interesuar dhe të kualifikuar që të dorëzojnë një ofertë/propozim për **mallrat(material, paisje, pune)/punët/shërbime** këshilluese për Ofertim të këtyre Materialit, paisjeve, puneve per projektin : **Ndërtimi i sistemit të ujitjes dhe Rezervarve për akumulimin e ujit- për ujitje së tokave bujqësore.**

a)Punët e dheut , Germimi i dy (rezervareve) dhe hapja e kanaleve-komplet

b)Punet e muratimit dhe beton-armesë-komplet

c)Punet e ujesjellesit dhe Kullimi ( duke perfshire blerjen e pompave dhe panellin elektrik) -komplet

d)Punët e instalimit te Pompave - blerjen dhe instalimin e elemteve percjellese per funksionalizim te sistemit-komplet

e) Punë e Elektrikes ( blerja e kabllave- elemteve te rrymes me montim dhe funksionalizim)-komplet

Afati për të kërkuar një Ftesë për Kuotim/sqarime tek adresa e cekur më poshtë (7 ditë nga data e publikimit)

Afati i dorezimit të Ofertave **15 ditë nga data e pranimit te ftesave** per kuotim, ofertat dorëzohen ne Adresen: **P.N, Fshati**

**Duravë-Istog- shteti Kosovë**

Për Informata Shtesë tel: **+383 44 731 464** dhe në email adresën: **sejdiarifaj@live.com**

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Argjent Avdyli nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit "Hajdar Dushi" në Gjakovë.

► Ferdez Hoxha nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesëm teknike "Nexhemdin Nixha" në Gjakovë.

► Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokal në qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

